KESHILLI I QARKUT VLORE

PLANI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NATYRORE

2014

Pjesa 1 – Bregu jugor



Vlore 2014

1. HYRJE

Parathënie (nga Kryetari i qarkut)

Bregdeti i Jonit është një perlë në rrjetin shqiptar të zonave natyrore. Bukuria natyrore e zonës, klima e saj relativisht e butë, trashëgimia kulturore intriguese dhe sasia e aktiviteteve argëtuese që mund të zhvillohen, të shoqëruara nga struktura të përzgjedhura akomodimi e bëjnë këtë zonë një magnet për turistët e huaj dhe vendas. Turizmi është identifikuar si një nga sektorët me potencialin më të lartë për rritjen ekonomike.

Qeveria Shqiptare është angazhuar të promovojë rritjen ekonomike brenda kontekstit të zhvillimit të qëndrueshëm duke konsideruar me rëndësi parësore çështjen e mbrojtjes së mjedisit. Bazuar në një politikë të qenësishme zhvillimi të qëndrueshme, të orientuar tek investimet në infrastrukturë dhe promovimin e sektorëve udhëheqës të ekonomisë përmes një ndërhyrjeje të integruar strategjike, qeveria ka ndërrmarë iniciativën për zhvillimin e integruar të Bregdetit Jugor të mbështetur në 4 programe[1] kyç: Programi i Investimeve Kapitale PIK; Rehabilitimi Arkitekturor i fshatrave te Bregut RAB; Investimet në Partneritet Publik Privat IP3 dhe Menaxhimi i Burimeve Natyrore të Bregut BNB.

Këshilli i qarkut të Vlorës është përfshirë në programin e menaxhimit të qëndrueshëm të bregdetit për ruajtjen e karakteristikave natyrore të zonës, rehabilitimin e burimeve natyrore të dëmtuara për shkaqe natyrore ose njerëzore dhe administrimin racional të tyre, si edhe promovimin e këtyre vlerave autoktone, me qëllim konceptimin e një turizmi të qëndrueshëm, të aplikueshëm për vizitorët e së tashmes dhe të së ardhmes. Qëndrueshmëria mjedisore konsiderohet të jetë çelësi për të nxitur rritjen ekonomike, sidomos në sektorin e turizmit pa rrezikuar pasuritë natyrore, por përkundrazi duke e përdorur mjedisin si një mundësi për të ndjekur një model të ri zhvillimi.

Si pasojë e kësaj ndërhyrjeje të integruar strategjike në bregdetin jonian, përmes përmirësimit të infrastrukturës, mbrojtjes së vlerave natyrore dhe kulturore, nxitjes së komuniteteve të vogla dhe të mesme të biznesit, zhvillimit cilësor dhe rehabilitimit të zonave nga ndërtesat e pakontrolluara, bregdeti i Jonit bëhet një destinacion i rëndësishëm i turizmit në Mesdhe, i njohur për mbrojtjen e mjediseve të tij, trashëgimisë dhe identitetit natyror dhe kulturore, ku sektori i turizmit është i mirëintegruar në një ekonomi të diversifikuar rajonale që do të sigurojë prosperitet dhe mirëqënie për banorët e vet.

[1] PIK – përfshin ndërhyrje në infrastrukturën rrugore parësore dhe dytësore ne bregdetin jugor, përmirësimin dhe ngritjen e sistemit të menaxhimit të ujërave të zeza, mbetjeve urbane…

RAB – përfshin ndërhyrjet rehabilituese të fasadave të fshatrave karakteristikë të bregut; Palasë?, Dhërmi, Vuno, Himarë…

IP3- përfshin iniciativa partneriteti publik privat në fushën e bujqësisë, blegtorisë, akuakulturës, etj.

1.1. Profili i qarkut Vlorë

Qarku Vlorë është i përbërë prej rretheve Vlorë, Sarandë, Delvinë. Qendër e Qarkut është qyteti i Vlorës, që është qendër tregtare, industriale dhe e ndërlidhjeve të shumta. Qarku Vlorë renditet i treti për nga madhësia pas atij të Shkodrës dhe Korçës. Qarku Vlorë ka 26 komuna dhe bashki nga të cilat 7 janë bashki dhe 19 janë komuna. Ndërsa me reformën e re territoriale, qarku i Vlorës eshte ndare në 7 njësi administrative bashkie. Shtrihet në pjesën jugperëndimore të vendit dhe laget nga deti Adriatik dhe deti Jon. Zona bregdetare pranë Qarkut Vlorë është një nga zonat më të bukura dhe me histori të pasur, është një rajon bregdetar me reliv të thyer dhe të shumëllojshëm, që me larminë e formave ka ndikuar direkt në klimën e këtij rajoni si edhe në llojshmërinë e fenomenit turistik.

Bazuar në strategjinë e qarkut 2011-2020 për zhvillimin prioriteti kryesor i qarkut të Vlorës është turizmi. Me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë mjedisore dhe kulturore, që do shërbejnë si tërheqja kryesore për turistët ndërkombëtarë (të cilët presin standarde të cilësisë së lartë nga një vend që aspiron integrimin në BE) është i nevojshëm një model për zhvillimin e turizmit, i ndryshëm nga ai që është ndjekur derimë tani, për ta orientuar atë drejt qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale. Kjo nënkupton krijimin e një oferte turistike më të larmishme, duke futur bregun dhe zonat e thella në itineraret tematike, duke përfshirë atraksionet e ruajtura mirë si dhe akomodimin dhe shërbimet e cilësisë së lartë.

Peisazhet e padëmtuara, vendet natyrore dhe zonat bregdetare (Parku Kombëtar i Llogarasë dhe Butrintit, gadishulli i Karaburunit, lagunat e Nartës, Orikumit dhe Butrintit, Riviera shqiptare, lugina e Shushicës, etj), konsiderohen si pikë e fortë e qarkut të Vlorës. Male të lartë, pyje natyrorë, makie dhe kullota të gjera, fshatra të mirë organizuar dhe të mirë vendosur, të rrethuar nga plantacione me pemë (zakonisht me pemë ulliri ose portokalli), përrenj, burime karstike me ujë të freskët dhe bregdeti me gjire, limane, plazhe të bukur krijojnë së bashku një peisazh shumë harmonik, skenik dhe magjepsës. Zona përfaqëson shembullin më të mirë në zonë të një bashkekzistencë të gjatë të populllsisë vendase dhe natyrës, ku shpesh interesat socialo-ekonomike dominohen nga ato të ruajtjes së natyrës.

Bregdeti jugor dallohet për diversitetin e habitateve dhe pasurinë me specie të florës dhe faunës. Ekosistemet detare dhe tokësore të Shqipërisë janë pjesë e një zinxhiri mesdhetar dhe ballkanik te ekosistemeve natyrore. Një pjesë e madhe e tyre ruhet në një gjendje natyrore që në vetvete përbën trashëgimi natyrore. I gjithë rajoni bregdetar jugor ka potenciale të mëdha për mbrojtjen e biodiversitetit dhe konservimin e natyrës në Shqipëri, të cilat mund të integrohen me zhvillimet potenciale turistike. Habitatet e pasura dhe të gjera të të gjithë zonës bregdetare i japin vendin kryesor për një plan veprimi strategjik. Pjesët përbërëse të këtyre habitateve të pasura përfshijnë: plazhet bregdetare, barrierat ishullore, zonat e lagëta dhe lagunat, monumentet e shumta natyrore dhe kulturore. Këto zona mund të tërheqin vizitorë që janë të interesuar për kombinimin e pushimeve të tyre me njohjen e natyrës.



Fig. 1 Qarku Vlore



Fig. 2 Zona objekt planifikimi

Krijimi i bazës për një menaxhim të qëndrueshëm të bregdetit për një mbrojtje më efektive të mjedisit dhe përdorim racional të burimeve bregdetare do të ndihmojë në rritjen e pamjes tërheqëse të rajonit, në shtimin e mundësive për përfitime ekonomike dhe mirëqënie të komunitetit rajonal si edhe në rikuperimin dhe përforcimin e ndjenjës së identitetit dhe të përkatësisë të mbarë komunitetit. Për këtë qëllim qarku i Vlorës, në koherencë më strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit, ka ndërrmarë nismën për menaxhimin e burimeve natyrore të ndarë në katër njësi të mëdha gjeografike, të cilat janë grupuar në bazë të karakterisitkave të ngjashme të burimeve natyrore:

1- Zona Bregdetare Jugore
2- Lugina e Shushicës
3- Bashkia Vlorë
4- Delvinë-Konispol

Në këtë paketë paraqitet platforma për menaxhimin e burimeve natyrore të bregdetit, shtrirja gjeografike e të cilit kufizohet prej parkut të Llogarasë dhe Gadishullin e Karaburunit në veri deri në kepin e Stillos në jug të vendit. Objektivat e këtij programi fokusohen në:

- Ruajtjen e karakteristikave natyrore të zonës,
- Rehabilitimin e burimeve natyrore të dëmtuara për shkaqe natyrore ose njerëzore
- Administrimin racional të tyre
- Promovimin e këtyre vlerave autoktone,

Me qëllimin final, konceptimin e një turizmi të qëndrueshëm, të aplikueshëm për vizitorët e së tashmes dhe të së ardhmes.

1.2. Zona bregdetare

Zona Bregdetare Jugore identifikohet me tetë rajone bregdetare të lidhura me njëra-tjetrën, të cilat përbëjnë së bashku rajonin e planifikimit funksional e efektiv për Menaxhimin e Integruar të Zonave Bregdetare. Këto territore janë:

1. Parku Kombëtar i Llogarasë dhe Gadishulli i Karaburunit në veri;
2. Parku Kombëtar i Butrintit dhe kufiri me Greqinë në jug;
3. Territoret që ndodhen brenda kufijve të pesë njësive administrative:
   - Bashkitë: Himarë e Sarandë dhe
   - Komunat: Ksamil, Lukovë dhe Xarë.

Parku Kombëtar i Llogarasë dhe Gadishulli i Karaburunit në veri

Llogaraja ndodhet rreth 40 km larg nga qyteti i Vlorës. **Gadishulli i Karaburunit** ka një profil bregdetar që karakterizohet nga kanione dhe shpella që mund të vizitohen vetëm me anije. Brigjet veriore dhe perëndimore kanë një gjatësi prej 14 km dhe bregdeti ndryshon drejtim veri-veriperëndim nga kepi i Karlovecit në gjirin e Bristanit. **Bregu i Kanalit** shtrihet për 30 km duke filluar nga gjiri i Bristanit e deri në Dhërmi. Profili bregdetar ndërpritet nga kanione dhe shpella që përfundojnë në hapësira shpellore me plazhe ranorë. Këtu gjenden burime ujore të freskët dhe pak të kripur që rrjedhin nga muret e kanioneve. Bregdeti përgjatë gjirit të Gramës ka qendra të trashëgimisë kulturore me vlerë të ndjeshme duke përfshirë: afreske skulpturore të periudhës së hershme kristiane, shkrime të periudhës helenike. **Ishulli i Sazanit** ka një vijë bregdetare prej 10 km. Mjedisi detar është i ndarë në dy gjire të vegjël me plazhe zhavorri dhe me thellësi të cekëta e shtretër barishtesh detare. Ky ishull fuksionon ende si bazë ushtarake, çka krijon pamundësinë e aksesit të lirë në të.

Parku Kombëtar i Butrintit dhe kufiri me Greqinë në jug;

Është zona bregdetare më jugore dhe shtrihet brenda një territori 20 km të gjatë. Kjo zonë disponon një potencial të madh për zhvillimin turistik për shkak të vetë afërsisë së saj me burime të shumta të trashëgimise natyrore dhe kulturore. Kjo zonë përfshin mjedise aquatike, tokësore dhe marine të Butrintit, të Ksamilit, kepit të Stillos dhe ishullit të Stillos. **Parku i Butrintit** është një nga qendrat më të mëdha të trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe në tërë gadishullin e Ballkanit. Parku kombëtar i Butrintit, duke përfshirë edhe qendrën arkeologjike dhe zonat përreth kanë statusin Ramsar. **Liqeni i Butrintit** është një zonë potenciale për mbrojtjen dhe restaurimin e biodiversitetit dhe është përfshirë në listen e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, me statusin "Ramsar", veçanërisht si habitate të shpendëve ujore. **Kepi i Stillos** është një zonë në pjesën

jugore të kanalit të Butrintit, në jug të lumit Pavllo, me plazhe të bukur dhe marina potenciale. Mjedisi marinar i ishullit të Stillos është shumë i dukshëm për ekosistem tipik mesdhetar e të shëndetshëm.

Territoret që ndodhen brenda kufijve administrativë të pesë njësive administrative:

- **Bashkitë: Himarë e Sarandë; dhe**
- **Komunat: Ksamil, Lukovë dhe Xarë.**

Saranda është një qendër turistike me një nga ekosistemet më të pasura dhe me ndikime të dyfishta të tokës dhe detit për zhvillimin e turizmit, falë pozicionit dhe karakteristikave fiziko-gjeografike. Në pjesën jugore të saj ndodhet Gadishulli i Ksamilit me një vijë bregdetare me gjatësi 25 km, i cili konsiderohet si një zonë me potenciale të mëdha natyrore me rëndësi të madhe për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Gjiri i Ksamilit dhe ishujt me të njëjtën emër me plazhet e vegjël ranorë dhe pyjet e zonës së makies përbëjnë plazhe të cilësisë së lartë.
Himara shtrihet përgjatë bregdetit te detit Jon, duke filluar nga veriu ne Llogara e deri në lumin e Borshit ne Jug. Mjediset natyrore dhe terrestriale dhe mjediset e fshatrave tradicionale midis Dhërmiut dhe Sarandës-Çuka, përmban mundësira të mëdha për të mbrojtur dhe zhvilluar peisazhin që përbën një nga atraksionet kryesore si pjesë e integruar e peisazhit bregdetar nga gadishulli i Karaburunit deri në kepin e Stillos.
Ndonëse vlera e peisazhit është kompromentuar nga zhvillimi i pakontrolluar në Sarandë e Ksamil dhe zhvillimet sporadike apo të rregulluara në mënyrë të papërshtatshme në Himarë dhe vendodhje të tjera, Bregdeti Jugor mbetet nje aset shumë domethënës i zhvillimit ekonomik në nivel kombëtar; ndërsa në nivel qarku i vetmi aset domethënës i zhvillimit ekonomik brenda kuadrit të planifikimit të zhvillimit për Bregdetin Jugor.

2. PROGRAMI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NATYRORE TË BREGUT

2.1. Metodologjia

Janë ndërmarrë një sërë studimesh mbi zhvillimin sektorial dhe hapësinor për t'i dhënë shtytjen e parë zhvillimit të turizmit përgjatë bregdetit jugor. Këto studime janë realizuar në harmoni me masterplanin e zonës bregdetare dhe planeve të përgjithshme rregullues të kësaj zone.
Grupi i punës së qarkut Vlorë, pasi shqyrtoi këto studime të mëparshme dhe u mbështet në konsulencën e ekspertëve mjedisorë si edhe me një "vlerësim në terren' të kushteve ekzistuese dhe potencialit të zhvillimit përgjatë zonës bregdetare jugore gjatë periudhës korrik-shtator 2014 inventarizoi burimet ekzistuese mjedisore për burimet e natyrore të bregut të jugut, analizoi dhe identifikoi problematikat e mundshme të cilat u përkthyen në nevojat për ndërhyrje përmes projekteve konkrete[2] në një platformë të menaxhimit të burimeve natyrore të bregut me synimet afatgjata:

[2] Shih për më shumë në kapitullin e projekteve të propozuara.

1- Ruajtja, rikthimi në gjendjen e mëparshme dhe përmirësimi i pasurive natyrore të rajonit

2- Njohja e këtyre pasurive si një vlerë e shtuar për zhvilllimin e një modeli novator të menaxhimit përmes veprimtarive të reja dhe alternative, sociale dhe ekonomike të qëndrueshme

Ekosistemet detare dhe tokësore të Shqipërisë janë pjesë e një zinxhiri mesdhetar dhe ballkanik të ekosistemeve natyrore. Një pjesë e madhe e tyre ruhet në një gjendje natyrore që në vetvete përbën trashëgimi natyrore. Ekosistemet tokësore përfshijnë tokë bujqësore, pyje, kullota, sipërfaqe joprodhuese urbane dhe troje ndërsa ekosistemet ujore përfshijnë liqenet, lagunat, lumenjtë, përrenjtë, burime ujore.

Bazuar në këtë ndarje të burimeve natyrore, problematikat kryesore të dëmtimit dhe traumës mjedisore në nivelin makro paraqiten:

- Administrimi i sistemit të ujërave të zeza te kanalizimeve ekzistuese sidhe te reja sidomos ne ndertimet pa leje
- Administrimi i integruar i mbetjeve urbane / zonave të kontaminuara nga mbetjet[3]
- Ndërtesat e pakontrolluara dhe të paligjshme që dëmtojnë fondin e gjelbër; të sipërfaqeve të gjelbëruara, tokave bujqësore, të bregdetit, (sidomos në zonat e Himarës dhe Sarandës).
- Shpyllëzimi i pakontrolluar dhe zjarret në zonat pyjore;
- Mbikullotja e të imtave
- Ndotja e burimeve ujore dhe kurrizeve ujëmbledhëse
- Prishja e ekuilibrave natyrorë peisazhikë - Guroret dhe minierat përbëjnë një dukuri tepër negative në shkatërrimin e natyrës e të peisashit, të habitateve dhe reduktimin e tyre
- Prishja e ekuilibrave të ekosistemit: Mbipeshkimi, peshkimi ilegal, gjuetia ilegale, grumbullimi jashtë kritereve i bimëve medicinale.
- Degradimi i habitateve, erozioni bregdetar, kodrinor dhe malor mbetet një dukuri në rritje dhe kjo per shkak te ndërhyrjeve në lumenjtë, në zonën bregdetare dhe nga prerja e pyjeve dhe zjarret.

Synimi i shumicës së projekteve ka parashikuar ndërhyrje për përmirësim të situatës së burimeve natyrore, ndërkaq që të tjerat kanë patur për qëllim mundësitë e shfrytëzimit efektiv dhe pozitiv të këtyre burimeve referuar veprimeve të mëposhtme:

1- Rehabilitimi i zonave me vlera të larta natyrore dhe peisazhore

2- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e parqeve natyrore në nivel rajonal

[3]Këto probleme po trajtohen nga programi PIK

3- Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zonave natyrore, i peisazheve dhe ruajtja e biodiversitetit

4- Përmirësimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonave të ndotura dhe të degraduara

5- Përmirësimi dhe pastrimi mjedisor i zonave të kontaminuara nga mbetjet

6- Rritja e sigurisë në zonat që janë nën ndikimin e paqëndrueshmërisë gjeologjike

7- Ndalimi i degradimit të mëtejshem të ekosistemeve dhe habitateve bregdetare dhe ligatinore të zonës

Klasifikimi i projekteve është bërë sipas tematikave të burimeve natyrore të bregut, si nxitje e praktikave të një menaxhimi të qëndrueshem të burimeve natyrore, zhvillimit të një turizmi miqësor ndaj mjedisit dhe formave të tjera të eko-zhvillimit, por duhet pohuar që këto ndërhyrje nuk shterin vetëm me këtë program.

2.2. Zonat e mbrojtura; Parqet; Monumentet e natyrës

Parqet kombëtarë dhe zonat e mbrojtura përbëjnë disa nga vlerat më të mëdha të vendit nga pikëpamja bioologjike, ekologjike, ekonomike dhe trashëgimisë natyrore. Monumentet e natyrës shquhen për shumëllojshmëri të peisazhit, florës dhe faunës tokësore dhe ujore. Parqet e përcaktuar në shkallë kombëtare për qarkun e Vlorës janë: Parku Kombëtar i Karaburunit; Parku Kombëtar i Llogorait; Parku Kombëtar i Butrintit.




Fig. 3 Zonat e mbrojtura ne jug te shqiperise

Situata e pyllëzimit në rastet e menaxhimit të parqeve lë për të dëshiruar, po ashtu edhe mjedisi përreth. Zjarret nga ana tjetër është një fenomen që riskon parqet. Kjo e ka burimin në bindjen e

barinjve se djegia e plotë e kullotave është mënyra më efektive dhe e thjeshtë për t'i përmirësuar ato. Për këtë arësye ekziston rrezikuqë zjarri të dalë jashtë kontrollit dhe kështu të mund të digjen edhe pyjet. Mungon plotësisht ripyllëzimi artificial, ose jane bërë shumë pak mbjellje. Zonat e aktiviteteve çlodhëse dhe argëtuese nuk janë të kontrolluara, dhe në këtë mënyrë, ato shkaktojnë mjaft ndotje, shqetësim për jetën e gjallë dhe rrezik zjarri.

Zjarret dhe dëmtimi i pyjeve nga prerjet e paligjshme ka sjellë prishjen e ekuilibrave natyrorë peisazhikë, shfaqjen e fenomenit të erozionit, sidomos në zonat bregdetare dhe lumore. Shkalla e dëmtimit të pyjeve dhe e mjedisit pyjor-kullosor ka qenë e konsiderueshme. Problem i madh mbetet edhe prerja e pyjeve.dhe djegjes së tyre nga zjarri, përndjekja e shpendëve dhe kafshëve të egra, gjuetia dhe përdorimi i mjeteve të ndaluara për gjueti.

a. Parku Kombëtar Llogara

Parku pyjor kombëtar i Llogarait është një vend me diversiteti biologjik dhe peisazhik të pasur ku historia e hershme dhe ajo e mëvonshme ka lënë gjurmët e saj. Ky park ndodhet rreth 40 kilometra në jug të qytetit të Vlorës, ndërmjet detit Adriatik dhe Jon. Pemët në këtë zonë kanë kurora të veçanta, që kanë marrë formë nga erërat. Një pemë e veçantë është "Pisha Flamur", e cila është një monument i rrallë natyror me vlerë shkencore të rëndësishme, e vizituar nga shumë turistë. Nga Qafa e Llogorasë, rreth 3 kilometra në perëndim, mund të shikohet shumë qartë deti Jon. Ky park ka vlera të padiskutueshme dhe klima e tij është një kombinim i mirë i ajrit të freskët malor me atë detar.

Projekti i integruar: Përmirësim dhe ruajtje e vlerave të Parkut të Llogarait

Kjo ndërhyrje parashikon një paketë projektesh bazuar në nevojat aktuale për përmirësim dhe ruajtje të vlerave të parkut, të cilat mund të gjejnë zbatim si një paketë e integrua,r por edhe si projekte të veçantë të ndarë në disa faza. Këto projekte konsistojnë në përmirësimin e higjenës së parkut përmes grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve në pika të caktuara, vendosjen e koshave për këtë qëllim; sistemim sheshi dhe ndërtim i një ballkoni-belvedere në harmoni me natyrën duke përdorur material drusor; plotësim infrastrukture përmes vendosjes së sinjalistikës pranë pikave të rëndësishme historike; përcaktimit të pikave të çlodhjes në pikat më të frekuentuara nga vizitorët si dhe përmirësimit të kalimit të tyre përmes zgjerimit të shtigjeve. Këto ndërhyrje parashikojnë edhe minimizimin e dëmeve nga zjarret, rrezik i pranishëm në parkun e Llogarait, edhe për shkak të pakujdesive të vizitorëve të ndryshëm.

Për zbatimin e projektit do bashkëpunohet me partnerët e interesuar ndaj këtij projekti si edhe me komunitetin e biznesit në Llogara, me komunietetin e nxënësve të zonës, ashtu si edhe me rolin e medias për sensibilizimin e opinionit për ruajtjen e mjedisit të këtij parku.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	ZONAT E MBROJTURA	Përmirësim dhe ruajtje e vlerave të Parkut të Llogarait	Përmirësim dhe ruajtje e vlerave të parkut te Llogarait	Llogara	TOTAL 12,000,000 ALL
2			Përmirësim i higjenes se parkut te Llogarait	Llogara	
3			Minimizimi i efekteve të zjarreve në park	Llogara	
4			Infrastrukturë lehtësuese për vizitorët në park	Llogara	
5			Përmirësim i sheshit të Qesarit/ Sistemimi i sheshit, ndërtimi i nje belvedereje (ballkoni)	Llogara	
6			Përmirësim i shtegut që çon te Stera e Kuinxhiut	Llogara	
7			Rehabilitimi i fushës së futbollit në Llogara	Llogara	Ne proces

b. Parku Kombëtar i Butrintit

Ky park ndodhet rreth 25 kilometra në jug të qytetit të Sarandës. Ai ka vlera të larta shkencore, turistike, arkeologjike, sociale dhe zbavitëse, të kombinuara gjithashtu me biodiversitetin e rëndësishëm. Sipërfaqja e parkut është 2500 hektarë. Është një zonë me rëndësi të veçantë për turizmin shqiptar: ai njihet kryesisht për turizmin kulturor në qytetin antik të Butrintit, i mbrojtur nga UNESCO, por gjithashtu për turizmin bregdetar në rajonin e Ksamilit dhe për ekoturizmin në liqenin e Butrintit. Laguna e Butrintit është një liqen me origjinë tektonike, me një ekosistem natyror me vlera të mëdha mjedisore dhe turistike. Ajo ka një sipërfaqe prej 16 km katrorë dhe lidhet me kanalin e Vivarit, i cili është 3,6 kilometra i gjatë. E gjithë sipërfaqja e Lagunës mbrohet falë dekretit që e përcakton si Park Kombëtar. Që nga viti 2002, ky territor ka statusin e Ligatinës së Mbrojtur, në përputhje me Konventën e Ramsarit. Ekosistemi është gjithashtu shumë i përshtatshëm për vrojtimin e shpendëve: në pyllin e zonës arkeologjike të Butrintit, pranë anës së liqenit, jetojnë 90 lloje të ndryshme shpendësh.

Projekti i integruar: Rehabilitimi kompleks i parkut të Butrintit

Kjo ndërhyrje parashikon disa projekte që integrohen mes vete me një qëllim final të përbashkët, por gjithashtu, mund të zbatohen edhe si projekte të veçantë bazuar në faza të ndryshme të ndërhyrjes.
Zona Qendrore 'A' në Parkun Kombëtar të Butrintit gjatë viteve ka pësuar dëmtime të rënda, degradim total të pyjeve dhe habitateve. Pjesa më e dëmtuar ndodhet rreth liqenit të Bufit, lumit të Pavllos, faqes së Milese, në Diapor etj, të cilët bëhen objektet kryesorë për ndërhyrjet rehabilituese. Pyjet e vjetër me ilqe (Q. ilex) janë zhdukur plotësisht në vitet 1975-1980. Të njëjtin fat pësuan edhe pyjet e valanidhit, dafinës, shelgut, frashërit etj. Ky shqetësim vazhdon edhe në ditët e sotme. Mbikullotja, prerjet, zjarret me qëllim ripërtëritjen e kullotës janë të pakontrolluara dhe po çojnë në degradimin e mëtejshëm të pjesës së mbetur. Këto degradime janë shoqëruar me

një varfërim të florës, faunës, humbje të vlerave social-ekonomike, kulturore, biodiversitetit të peisazhit si edhe reduktim të shpendëve.




Fig. 4 Parku i Butrintit

Ky rehabilitim do të rikthejë vlerat e humbura të Parkut të Butrintit, mjedisit dhe peisazhit në tërësi. Rivendosja e pyjeve në kodrat e Diaporit, Malit të Sotirës, Shëndëllisë, Shën Dhimitrit do të përmirësojë dukshëm strukturën e peisazhit, do të shtojë jeten e egër të faunës që u përshtatet këtyre mjediseve. Ky rehabilitim do të shërbejë gjithashtu për ndërgjegjësimin e komunitetit që e rrethon, për rëndësinë e Parkut Kombëtar të Butrintit në veçanti, mjedisit në tërësi dhe marrëdhënien e drejtë që komuniteti duhet të ketë me mjedisin.

Parashikohet rehabilitimi i pyjeve tejet të degraduar, si rrjedhojë e prerjeve, dëmtimeve, djegieve, mbikullotjes në Malin e Sotirës, Diaporit, Shën Dhivrit, Shëndëllisë, Kalivoit si edhe rritja e sipërfaqes së gjelbër përmes mbjelljes së fidanëve të bimëve karakteristike të zonës: valanidh, dushk, ilqe, dafinë, etj. Sipërfaqja rehabilituese mund të shkojë rreth 200 ha.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	**ZONAT E MBROJTURA**	Punime komplekse për rehabilitimin e pyjeve me qëllim rritjen e vlerave të parkut të Butrintit	Rehabilitimi i parkut të Butrintit përmes krasitjes dhe shkalbëzimit të valanidhit të rritur	Butrint	**TOTAL (120,401,883 All)**
2			Rehabilitimi i parkut të Butrintit përmes luftimit të bimës së agaves	Butrint	
3			Rehabilitimi i parkut të Butrintit përmes përmirësimit të kullotës në Aliko-Mile	Butrint	
4			Rehabilitimi i parkut të Butrintit përmes përmirësimit të lisit nëpërmjet ricungimit	Butrint	
5			Rehabilitimi i parkut të Butrintit përmes ndërhyrjeve përmirësuese të pemëve	Butrint	
6			Rehabilitimi i parkut të Butrintit përmes pyllëzimit me 1 ha Ilqe dhe dafinë	Butrint	
7			Rehabilitimi i parkut të Butrintit përmes pyllezimit me valanidh dhe ilqe me farë	Butrint	
8			Rehabilitimi i parkut të Butrintit" përmes pyllezimit me 1 ha valanidh dhe bungë	Butrint	
9			Rehabilitimi i parkut të Butrintit përmes shërbimeve kulturale në objektet e pyllëzimit	Butrint	
10			Krijim brezash kundër zjarrit në parkun e Butrintit	Butrint	
11			Krijim fidanishteje në parkun e Butrintit, 1000 m katrorë	Butrint	
12			Mbjellje fidansh ulliri	Butrint	
13			Përmirësim kullotës në zonën Aliko-Mile	Butrint	

c. Zona e mbrojtur Sazan - Karaburuni

Sazani është ishulli më i madh në Shqipëri, i gjendur në anën veriperëndimore të gadishullit të Karaburunit, rreth 12 milje nga porti i Vlorës. Ka një sipërfaqe prej 5,7 km, me gjatësi 4,5 km dhe me gjerësi maksimale 2 km. Në antikitet ai quhej Sason. Ishulli ka formën e një blloku shkëmbor, me brigje të thepisura, veçanërisht në pjesën perëndimore të tij. Në pjesën juglindore ndodhet plazhi ranor Admiral, i cili njihet për ujin e tij shumë të pastër. Gadishulli i Karaburunit ndodhet në anën perëndimore të gjirit të Vlorës. Ai është gadishulli më i madh në Shqipëri, rreth 16 km i gjatë dhe 4,5 km i gjerë. Gadishulli strehon shumë plazhe të vogla, siç janë gjiri i Arushës, plazhet e Gramës dhe të Dafinës, të cilat janë të shquara për ujërat e thella dhe të pastra. Në shkëmbinjtë e

gjirit të Gramës ndodhen një sërë mbishkrimesh në gjuhën greke e latine që datojne më shumë se 2000 vjet më parë, çka e ka bërë këtë gji të konsiderohet si ‘’ditari shkëmbor’’më i pasur në Mesdhe.
Brigjet e Gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit karakterizohen nga një shumëllojshmëri peisazhesh me shkëmbinj të pjerrët e të pakalueshem, me shpella, hone, kepe, plazhe të vegjël e gjire. Këto formacione tërheqëse bëhen edhe me interesante për syrin e vizitorit falë bimësisë së zhvilluar mirë, e cila mbulon pothuaje të gjithë gadishullin që nga maja e malit e deri në breg.




Fig. 5 Parku i Karaburun Sazanit

Per te respektuar rregullat baze te zones se mbrojtur propozohen tre projekte per krijimin ne rradhe te pare te nje plani menzaxhimi specifik te zones sidhe perdorimi i tije si nje vlere shtese ne jeten e rajonit vlore, ne respekt te destinacionit si zone e mbrojtur.
Parku detar Karaburun-Sazan është i vetmi park detar në Shqipëri dhe si i tillë duhet mbrojtur dhe zhvilluar me kujdes të veçantë për potencialet e mëdha turistike që ofron. Ky park ka akses të limituar për momentin, por Qeveria e Shqipërisë ka prioritet mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Në këtë kontekst në bashkëpunim me Agjencinë Franceze të Ruajtjes së Bregdetit është propozuar një program menaxhimi për këtë zonë. Në këtë plan menaxhimi janë të përfshira të gjitha veprimet që nevojiten për shpalljen e Sazanit si zonë e mbrojtur, gjithashtu edhe për krijimin e strukturave të menaxhimit, që do jenë përgjegjës për zbatimin e planit të menaxhimit në zonën e mbrojtur detare dhe tokësore. Gjithashtu, me qëllim rivitalizimin e Karaburunit parashikohet ndërtimi i një pakete turistike në zonën e Karaburunit përmes një sistemi të elementeve bazë dhe një infrastrukture për të ofruar perspektiva të reja turistike. Projekti i gjirit të Gramës ka për qëllim promovimin e kësaj zone të veçantë ku ndërthuret

mrekullisht monumenti natyror dhe kulturor i vetë gjirit të Gramës duke konsideruar të rëndësishëm ruajtjen dhe monitorimin e kësaj zone.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	ZONAT E MBROJTURA	Promovimi i zonës së Sazan Karaburunit	Plan Menaxhimi për ishullin e Sazanit dhe gadishullin e Karaburunit	Sazan	
2			Ura e Gjelbër përmes Adriatikut – The Green Bridge through Adriatic	Karaburun	480,000 €
3			Promovimi i vlerave të gjirit të Gramës	Karaburun	

d. Monumentet e natyrës

Monumentet e natyrës shquhen për shumëllojshmëri të peisazhit, florës dhe faunës tokësore dhe ujore. Ndërtesat dhe monumentet e trashëgimisë të caktuara dhe të mbrojtura në nivel kombëtar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 676, date 20.12.2002 janë shpallur zonë e mbrojtur, ndaj duhen zbatuar të gjitha kriteret që kanë këto zona. Monumentet e natyrës për qarkun janë 85 të tilla, ndërsa për zonën e studimit të këtij plani janë identifikuar 30. Disa prej këtyre monumenteve kanë nevojë të sigurohen dhe rehabilitohen, duke marrë në konsideratë përgjithësisht monumentet bio-natyrore; për një pjesë tjetër është i nevojshëm promovimi i tyre përmes krijimit të shtigjeve për të patur akses me qëllim turistik, ndaj qëllimi i projekteve të kësaj pakete të integruar është rehabilitimi dhe sigurimi i monumenteve natyrorë si dhe lehtësimi i aksesit në to.

Një problematikë tjetër që ndeshet me këtë tematikë është mungesa e sinjalistikës dhe njohjes së këtyre monumenteve nga publiku i gjerë turistik, duke përjashtuar banorët e zonave specifike. Duke qenë se këto zona të rajonit bregdetar karakterizohen nga një numër i konsiderueshëm i monumenteve natyrore, por edhe atyre të trashëgimisë kulturore, propozohet një paketë projektesh që parashikon sinjalistikë të integruar të të dy llojeve të monumenteve për zonat ku ekzistojnë këto resurse me potencial turistik. Mendohet që kjo sinjalistikë të ndërtohet në qendër apo në shëtitore të zonës (në pjesën e frekuentuar më së shumti nga turistët) duke respektuar karakteristikat e zonës dhe në harmoni me natyrën në formën e një instalacioni Konkretisht, propozimi paraqitet si projekt-pilot[4] për 6 zona të bregut: Palasë, Dhërmi, Vuno, Himarë, Borsh, Sarandë.

Një aspekt i rëndësishëm është edhe promovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore të botës nënujore brenda territorit shqiptar të bregdetit jugor përmes propozimit të një harte treguese e cila do të gjenerojë informacionin e nevojshëm për qëllime turistike dhe mund të integrohet edhe

[4] Kjo paketë propozohet edhe si një mundësi rrjetëzimi sinjalistike për monumentet e natyrës dhe kulturës edhe për pjesën tjetër të rajonit.

me projektin e qendrës së zhytjes që do të prezantohet më poshtë nën tematikën e Hidrologjisë /Bregdetit.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	MONUMENTET E NATYRËS	Rehabilitim dhe sinjalistikë e monumenteve natyrorë dhe kulturorë të Bregut	Palasë: 2 monumente natyrorë	Himarë	proces
2			Dhërmi: 8 monumente kulturorë dhe 2 monumente natyrorë	Himarë	proces
3			Vuno: 8 monumente kulturorë dhe 2 monumente natyrorë	Himarë	proces
4			Bashkia Himarë: 10 monumente kulture dhe 4 monumente natyrorë	Himarë	proces
5			Borsh: 2 monumente kulturore dhe 4 monumente natyrorë	Borsh	proces
6			Bashkia Sarandë: 15 monumente kulture dhe 11 monumente natyrorë	Sarandë	proces
7			Hartëzim i objekteve të trashëgimisë kulturore të botës nënujore brenda territort shqiptar të bregdetit jugor	Proces	

2.3. Peisazhi

Gjatesia aktuale e pjeses bregdetare te zones se zhvillimit, nga gadishulli i Karaburunit ne veri, deri ne kufirin greko-shqiptar ne kepin e Stillos ne jug, ka kuptim si nje njesi e integruar e peisazhit bregdetar, e percaktuar ne thelb nga struktura e saj gjeologjike dhe gjeomorfologjike me shpate shkembinjsh gelqerore, prane dhe pothuajse paralel me bregun, perfshire dhe sistemin e luginave erozive, dhe nga forma konkave e tokes qe formon dhe gadishullin e Karaburunit ne veri dhe Korfuzin dhe kepin e Stillos ne jug. Kjo eshte e vetmja pjese e bregdetit shqiptar qe mali takon detin. Shpatet jugire te maleve e ndajne zonen e bregdetit nga pjesa e brendshme e vendit, si nga ana fizike, ashtu dhe nga ajo vizuale. Kjo njesi e peisazhit, ne fakt, vazhdon deri ne fund te malit Lungare ne jug te Vlores, para se bregu te ndryshoje karakterin dhe te kthehet ne nje bregdet te sheshte dhe te gjere, dhe deti Jon ne jug kalon ne ate Adriatik ne veri te kesaj pjese.
Peisazhi bregdetar ndahet ne 8 zona te cilat jane prezantiar nga veriu ne jug.
Zonat e peisazhit jepen ne figuren 6



Fig. 6 Zonat me peisazhe karakteristike

Zona 1: Kepi i Stillos ngrihet rreth 300m, forme rretore ne piken e takimit me detin. Kepi percakton kufijte e lahunes dhe te ligatinave te Parkut Kombetar te Butrintit, prane vendit te daljes ne det. Mali i Stillos ka shume lugina qe bien ne det ne tre drejtime. Me e madhja, bie ne det dhe formon nje plazh me rere, me tre ishuj te vegjel ne det, njeri prej te cileve eshte brenda kufirit grek. Edhe disa nga luginat me te vogla perfundojne me plazhe. Faqet perendimore kane nje mbulese te
rralle me pishe bregdetare. Shumica e siperfaqes mbulohet me barera te egra dhe ka te ekspozuar damare te shkembinjve gelqerore.

Zona 2: Butrinti Ekosistemi i Butrintit eshte nje nga me te pasurit ne Shqiperi dhe funksionon si nje njesi e vetme ekologjike. Perfshin 2 liqene (Butrinti dhe Bufi) si dhe nje numer te madhe ligatinash. Sistemi pershkohet nga 3 lumenj 10 perrenj poranveror dhe qindra perrenj te vegjel. Ne sistem ben pjese dhe burimi i Syrit te Kalter nga ku buron lumi i Bistrices. Kufijte jugor te lugines perbehen nga male me shpate te thepisura qe shtrihen deri ne fushen e Vrines. Erozioni i kodrave ka nxjerre shpate te gjera dhe te sheshta me nje shtrirje lineare te shkembinjve gelqerore. Secili prej ketyre shpateve ka nje karakter te gjashem me ate te bregdetit mes Sarandes dhe Ksamilit. Fundet e luginave kane qene te pasura me ligatina he specie bimore.

Zona 3:Nga Saranda ne Kepin e Skales –Shpatet me pamje nga deti
Giri i Sarandes i formuar nga pllakat gelqerore nga Gryka e Gushores dhe Qafa e Gushes qe bien direct ne det duke formuar plazhe te vogla me rere te trashe ne dalje te ujembledhesave dhe me bimesi te vogel ne faqen nga deti, dhe me shkurre ne anen e brendeshme.
Sarandes – Ksamili. Zone e perbere nga kodra te uleta (me e larta 200 m dhe me e uleta 50 m) qe lidhen nga kalime nepermjet detit ne drejtim te kenetave te Vrionit dhe/ose Liqenit te Butrintit ne pjesen e brendshme. Shume prej kodrave jane te mbuluara me shkurre te drunjta siper bregdetit. Vija bregdetare eshte ekarakterizuar nga nje numer I vazhdueshem gjiresh, gjuhezash dhe limanesh, me plazhe me rere te bardhe.
Ksamili gjendet ne nje gji i dale nga liqeni I Butrinitit, dhe nje seri gjiresh pergjate detit “pickojne” vargmalin deri ne 700 m ne gjeresi. Ishujt jane te pyllezuar dhe meshume pisha te zhvilluara ashtu sikurse eshte dhe pjese perballe ishujve.
Kepi I Skales eshte nje mal I gerryer (rreth 100 m I larte) rreth 4 ha ne madhesi. Kodra eshte e nderprere me shume lugina te gerryera qe madhesive te ndryshme me shpate te mjaftueshme per mos tu pare nga njera tjetra.. Pjerresia mbi det eshte e mbushur me dru, kurse pjesa me e larte
ka bimesi.

Zona 4: Nga Kakomeja ne Sarande
Kakome. Gjiret e nderprere jane formuar nga shtresa gelqerore te ngritur perpendikular me gjendjen e tyre origjinale si shtresa te shtratit te detit. Kakomeja eshte gjiri me I madh I ketyre ndarjeve dhe eshte zmadhuar nga gerryerja e vazhdueshme e shtresave. Toka midis qafes dhe detit perbehet nga nje peisazh I parregullt me kodra te vogla dhe shtreter qe perfundojne ne nje zone mjaft te gjere dhe te shsesht para plazhit. Ne fund te ketij shpati gjendet nje peisazh interesant I formuar nga veprimi I dallgeve.
Nga Kakomeja deri ne Sarande. Peisazhi karakterizohet nga lugina e thella dhe mjaft te gjera qe kalojne nga maja e vargmalit per ne det duke krijuar nje hapesire te izoluar qe nuk mund te shikohen me njera tjetren. Bregdeti perbehet nga pllaka gelqerore te formuara nga errozionet, dhe gjire te vegjel te nderprere dhe plazhe me rere dhe gure zalli. Bimesia perbehet nga bari dhe peme te rralla. Pemet dendesohen ne mes te latesive te vargmalit dhe me pas zhduken plotesisht ne maje prane formacioneve te trashimit.

Zona 5: Borsh deri ne Kakome duke perfshire pellgun e Lugines se Fterres
Borsh. Lumi I Borshit ka nje shtrati te gjalle me specie bregore pergjate gjithe rruges se tij deri ne gryke derdhje. Shpatet e maleve jane te mbuluara me shkurre te perziera me pak pisha. Delta perfundon ne nje plash te gjate dhe te gjere. Plazhi eshte I gjate gati 8 km dhe vazhdon te ngushtohet prane Lukoves. .
Borsh deri ne Lukove Peisazhi karakterizohet nga shpate te buta dhe te valezuar, te nderprera nga shume perrenj pranverore. Shpatet e pjerreta jopjellore jane te mbuluara me shkurre dhe
pisha.
Lukova. Ne pjesen perendimore te vargmalit te Kurveleshit e formuar nga nga nje rrip i gjere toke te lerueshme. Peisazhi nderpritet nga perrenj pranverore, njeri prej te cileve formon nje ujevare te

mrekullueshme. Kater luginat qe futen direkt ne lindje dhe juglindjes se Lukoves futen ne brendesi te tokes dhe happen ne prane ose drejt e ne det duke formuar plazhe te vegjel me rere te trashe te bardhe.
Qafa e Perparimit nga Lukova futet lehte ne toke nga bregu, per ne luginen e lumit te Kalase, eshte formuar nga dy vargmale qe shkasin pas njeri tjetrit. Faqet e siperme kodrinore jane te mbuluara me shkurre dhe pishe dhe gure gelqerore.
Vargmali I Eremisit eshte nje shpat mjaft unifor, i pjerret nga pjesa e brendeshme, dhe me pak e pjerret nga pjesa e detit. Nga deti, zona duket si nje shpat i vetem gati pa reliev. Cepi verior eshte prane nje plazhi me rere te ashper dhe me bimesi te dendur. Shpati ka bimesi dhe shperndare dhe bar.
Krorez. Burimet e Krorezit presin nje lugine te kendshme nga ana e detit te vargmalit te Eremisit. Forma V klasike e lugines ne jug rrethohet nga shkembijte dhe zgjerohet ne dy plazhe te gjate me rere te trashe, qe ndahet nga nje e dale e vogel shkembijsh me gjire te vogla dhe pellgje te paster.

Zona 6: Himara – Kanioni I Vunoit drejt Qeparoit
Kanioni I Vunoit i formuar nga perrenjte e Vunoit permes terrenin malor per te dale me pas ne plazhin e Gjipes. Plazhi eshte I perzier me guraleca dhe rere. Kanioni eshte I ngushte dhe muret jane shume te larta duke krijuar nje tipar unik te bregdetit jugor. Shume peme fiqsh te eger ndjekin kete rruge, te perzier me specie indigjene bregore.
Jala. Lugina e Jales perfundon ne nje plazh te gjere dhe te gjate te perzier me guralece dhe rere; ka nje te dale te gureve gelqerore qe ndan nje plazh me te vogel ne veri. Pjerresite jane te mbuluara me shkurre, megjithate pjerresite jugore jane me te zhveshura se sa pjerresite veriore. Pejsazhi I plazhit eshte unik dhe kjo gje rritet dhe nga forma e kepit te jugut, si dhe te dalat shkembore ne veri.
Himara Mali ndodhet larg bregut te detit dhe vija bregdetare zgjerohet dhe gradualisht kalon nepermjet disa luginave, kodrave dhe kepeve te vegjel. Bregdeti I himares ndahet ne dy plazhe te ndara nga nje kreshte me gure gelqerore qe del ne det. Ne pjesen jugore te plazhit te Spiles ka shume burime me uje te fresket. Bimesia perbehet nga pisha te rralla dhe me shkurre te perziera.
Gjiri I Porto Palermos. Ne mes te gjirit ndodhet nje gadishull I gurte I vogel I cili ndahet nga toka me nje ngushtice e vogel e ceket. Ne pjesen veriore ka nje burim te ftohte nentokesor. Pjesa veriore e gjirit kufizohet nga nje gadishull I holle ne formen e gishtit. Ky gadishull ndahet nga toka me nje lugine e nje delta ne breg. Linja bregdetare eshte shkembore me plazhe te vogla midis. Peisazhi eshte kryesisht I thate me shkurre ne pjerresi.
Luginat e Qeparose dhe Borshit Direkt ne lindje te cepit jugor te vargmalit te Cikes (Porto Palermo), Mali I Kurveleshit ndahet ne dy gishterinj dhe kthehet ne jug parallel me at te Cikes, ku takohen me detin ne Qeparo dhe Borsh. Ujesjellesat dhe perrenjte pranverore te Kudhes perendimore dhe Fterres lindore kufizohen nga keto tre vargmale ne formen e gishterinjve dhe takohen me detin. Luginat jane me te ngushta dhe futen me shume ne brendesi te tokes ne krahasim me luginat e ceketa te Himares. Kanionet karakterizohen nga shkembijte dhe vargmalet nga te dyja anet dhe kane pamjen e nje vendi gjeomorfologjik. Kjo zone karakterizohet nga shume burime. Ketu kalon dhe burimet e Tepelenes qe dalin nga pjesa lindoe e Malit te Gjere. Luginat happen ne plazhe te gjera.
Qeparo Lugina e Qeparose hapet ne nje delte te gjere prane bregut dhe perfundon ne nje plash te gjate renor dhe me gure zalli. Pergjate vijes bregdetare, nen det, ka shume burime te ujrave te embel, qe e bejne ujin e detit te ftohte.

Zona 7: Karaburuni deri ne Dhermi
Gadishulli I Karaburunit dhe vargmali I Rrezes se Kanalit paraqitet si nje pejsazh unik. I gjithe gadishulli takohet me detin ne rrepire dhe ka shkembinj te paarritshem. Bregu perendimor eshte I larte, I fragmentuar me shume copetime, kavitete, hapesira dhe plazhe te vogla. Praktikisht, zona nuk ka bimesi, pervec disa pemeve ne grumbuj te vegjel dhe barerave te egra, dhe nuk ka asnje burim te ujrave te embla.

Nga Llogaraja ne Dhermi. Vargmali i Cikes ecen paralelisht me bregdetin dhe ofron nje nga pamjet me te vecanta te bregdetit shqiptar, ajo ka nje lidhje vizuale me detin drejte ne jug dhe ne gadishullin e Karaburunit ne perendim. Karakteri i bregdetit nga Llogaraja drejt Himares kufizohet nga lartesi te medha te Malit te Cikes qe bien parallel me vijen bregdetare, ka pjerresi dhe afersi me detin. Grumbullime pemesh natyrale me pisha realizojne nje pamje ne pjeset e pjerreta midis daljeve te ekspozuar te gureve gelqeror. **Lugina e Palases** eshte nje lugine e gerryer si dhe delte e krijuar nga vijat e dala nga burimet. Pjesa veriore e siperme (rreth 2,000 metra) e sistemit permbledh zona me pisha qe jane pjese e ParkutKombetar te Llogarase. Speciet bregore rriten pergjate sistemit te degezuar te ujendaresve. Delta eshte me bimesi dhe perfundon ne dy rripa plazhi te ndara nga nje zgjatim prej guri gelqeror qe vazhdin deri ne det. Plazhet jane normale ne madhesi dhe rera eshte e bardhe. Plazhet perbehen nga guraleve te vegjel gelqeror te perzier me rere.

Zona 8: Lugina e Orikumit drejt Qafes se Llogarase, eshte krijuar nga sistemi I ushqimit te rrymes se Dukatit. Zona e deltes eshte e gjere, dhe eshte nje zgjatim integral I fundit jugor te gjirit te Vlores. Linja bregdetare perfshin zona me plazhe te gjera me rere. Laguna dhe mocali i Orikumit sigurojne ambjente per migrimin e zogjve dhe eshte shume i vecante per koloninte e kafsheve, panvarshisht mases se tij te vogel. Fusha te meparshme bujqesore, qe tashme jane ugar, po kthehen ne vende per lule te egra indigjene dhe per barishte te egra. Zona e Lugines se Dukatit qe ngrihet drejt Qafes se Llogarase eshte pjeserisht e mbuluar me pisha, ne menyre te shperndare me zona te gjalleruara me peme mesdhetare. Burimet ujore dhe shtratiujor permban specie te vecanta indigjene.

Keto zona bejne pjese tek atraksionet turistike kryesore te jugut te shqiperise, dhe akoma te pa dëmtuara ne menyre te pa riparueshme. Rreziqet kryesore vijne nga ndertimet pa leje sidhe shfrytëzimi pa kriter i disa zonave per qellime ekstraksioni materialesh te ngurta.
Propozimet per nderhyrje ne vijim i përkasin si sferes se riparimit te disa demve mjedisore po edhe promovimit te peizazhit.

a. Rivitalizim i zonave peisazhike; guroreve

Guroret[5] përbëjnë një dukuri tepër negative për shkatërrimin e natyrës dhe peisazhit, të habitateve dhe reduktimit të tyre. Prania e tyre është në kundërshtim me objektivat e zhvillimit duke krijuar një pamje aspak estetike, por edhe shqetësime të dukshme ekologjike. Në disa raste, këto gurore janë kthyer në një masakër të vërtetë mjedisore si rezultat i shfrytëzimit jashtë kritereve të përcaktuara në lejet mjedisore për biznese të ndryshme që operojnë në terren. Rast flagrant ka qenë identifikimi i luginës së Botarit në Borsh ku ndërhyrja për rehabilitimin e zonës është thuajse i pamundur për shkak të pasojave të rënda mjedisore. Për këtë rast qarku Vlorë ka bërë denoncim për të mos lejuar thellimin e kësaj masakre të pashoq. (Foto?)

Gjithashtu, në kuadër të kësaj iniciative grupi i punës është në proces të vlerësimit të të gjitha guroreve në terrenin e bregdetit, me qëllim ekuilibrimin e shfrytëzimit të terrenit të përcaktuar brenda një rregulloreje kriteresh në lejet e dhëna mjedisore. Këto rregullore specifike janë të nevojshëm për të kontrolluar dhe menaxhuar: guroret e hapura për ndërtim dhe për materiale mbushjeje; heqjen e mbeturinave, heqjen dhe largimin e materialeve të tepërta mbushëse dhe

[5] Nuk është përfshirë gurorja në hyrje të qytetit të Sarandës duke qenë se është përfshirë si projekt në programin PIK

materialeve të ndërtimit/prishjeve. Gjithashtu rregullore të tilla duhet të mbulojnë vendndodhjen dhe menaxhimin e trojeve, me kërkesa specifike lidhur me operacionet me ndikim të ulët dhe rehabilitim përfundimtar pas përdorimit.

Propozohen katër projekte në zonat: Dhërmi, Piqeras, Ksamil-Butrint, ishujt e Ksamilit. Këto projekte synojnë rehabilitimin e këtyre zonave të ndotura dhe dëmtuara përmes sistemimit dhe vendosjes së barrierave antierozive gjeosintetike në harmoni me mjedisin përreth. Duke marrë në konsideratë specifikat e guroreve të mësipërme, gjithashtu edhe nevojat e paraqitura nga studimi në terren i zonës së bregut propozohet që gurorja në Dhërmi të tranformohet në një shesh multifunksional, ndërsa kava në fshatin Piqeras në një ambjent për parkimin e makinave.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	PEISAZHI	Rivitalizimi i guroreve	Rehabilitimi i gurores në Dhërmi dhe transformimi në një shesh multifunksional	Dhërmi	32,708,810 All
2			Përmirësimi i peizazhit përmes rehabilitimit të kaves pranë fshatit Piqeras	Piqeras	
3			Përmirësim i peisazhit natyror gjatë rrugës hyrëse Ksamil-Butrint	Ksamil-Butrint	7,038,000 All
4			Rehabilitimi i pjesës së eroduar nga zjarri në ishujt e Ksamilit	Ishujt e Ksamilit	1,153,670 All

b. Shtimi i sipërfaqes së gjelbëruar në zonat turistike

Mbjellja e pemëve dhe bimëve dekorative në funksion të krijimit të peisazhit është përgjithësisht e inkurajuar në të gjithë zhvillimet ekzistuese dhe të reja, si një mjet për të rritur edhe me shume interesin pamor të mjedisit. Në këtë kuadër propozohet shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara në zonat turistike duke u përqendruar në modelin e ri të zhvillimit përmes këtyre programeve të integruara për zhvillimin e bregdetiti jugor dhe konkretisht: gjelbërimi i rrugëve specifike që kanë hapësirë për këtë ndërhyrje të ndërtuara/risktrukturuara përmes programit PIK në zonën bregdetare; dekorimi i fasadave të fshatrave karakteristikë të bregut që janë përfshirë në programin RAB. Mbjellja e pemëve dhe bimëve dekoruese do të bëhet në respekt të llojeve tradicionale lokale si qiparis, ulli, bli, pishë, palmë, karafil, bungëvile, mimoza, etj.

Gjithashtu, në funksion të vlerësimit të mjedisit, por edhe si një çështje e ndjeshme e komunitetit është propozuar gjelbërimi i varrezave me qiparis dhe/ose bli duke respektuar edhe këtë lloj peme si traditë religjioze e zonës së bregut. Është në proces vlerësimi i të gjitha zonave të varrezave.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	PEISAZHI	Shtimi i sipërfaqes së gjelbëruar	Gjelbërim i rrugëve / PIK		
2			Gjelbërimi anësor i aksit rrugor Ura e Gajdarit-Dermish	Sarandë	332,495 €
3			Gjelbërimi i Gropës së Patates Sarandë	Sarandë	
4			Kurora e Sarandës	Sarandë	
5			Gjelbërim i varrezave	Borsh...	
6			Dekorim i fasadave /RAB		

c. Atlas fotografik

Zona nga gadishulli i Karaburunit deri në kepin e Stillos përbën një njësi të integruar të peisazhit bregdetar. Njësia e peisazhit bregdetar ndahet në 8 zona të peisazhit; kepi i Stillos – pjerrësi që sheh detin; Butrinti - pellgu më i madh ujëmbledhës; Saranda deri te Kepi i Shkallës – pjerrësi që shohin detin; Kakome deri në Sarandë- pjerrësi që shohin detin, Borsh deri në Kakome përfshirë pellgun ujëmbledhës të luginës së Fterrës; Himara –kanioni i Vunoit deri në Qeparo-pjerrësi që shohin detin dhe pellgu ujëmbledhës i luginës së Orikumit deri në qafën e Llogarasë dhe gadishulli i Karaburunit. Atlasi fotografik i zonave të peisazhit është një instrument i njohjes së identiteteve të ndryshme territoriale në qarkun tonë dhe ofron një pasqyrë të vendeve me potencial të rëndësishëm panoramik. Për këtë do të shfrytëzohen fotografitë nga zonat e cilësuara me rëndësi dhe të ndjeshme nga aspekti i peisazhit të shoqëruar edhe me spjegime të vendndodhjes së këtyre zonave.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	PEISAZH	Promovim i peisazhit	Krijimi i Atlasit fotografik	Bregu i jugut	
2			Krijimi i rrjetit informues dhe promovues përmes atlasit fotografik / Mania Card	Tiranë	

d. Rrjet pikash panoramike

Në rrugën nacionale Vlorë - Sarandë gjenden disa zona të sheshta e të mbetura mënjanë, si pasojë e ndërtimit të rrugës apo të ndërtimeve pa leje, të cilat gëzojnë një pamje panoramike të veçantë. Këto pika, ndër të tjera, përdoren vazhdimisht edhe nga turistët e shumtë, të cilët ndalen për të pushuar dhe për të bërë fotografi. Këto pika, rezultat i dëmtimeve të terrenit nga ndërtimet, mund të riparohen me një investim shumë të vogël dhe të përdoren, jo vetëm si pika pushimi, por edhe si pika informative e kulturale (belvedere) . Funksionet e kësaj hapësire të re mund të jenë, përtej pushimit dhe panoramës, edhe në funksion të informimit mbi pasuritë natyrore dhe kulturore të zonës përreth. Është parashikuar një sistem informimi me tabela mbi murin e ulët në këmbët e vizitorit të objekteve apo zonave që mund të shihen në çdo drejtim. Për te mbuluar pjesën e pastrimit, mirëmbajtjes dhe sigurisë është parashikuar dhënia me koncesion e nje kioske për shitje

të produkteve tipike, shfrytëzuesi i të cilës do të menaxhojë edhe sheshin. Janë parashikuar disa pika pika panoramike që do të jenë të integruara si rrjet i identifikueshëm përmes të njëjtit sistem informimi dhe menaxhimi.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	PEISAZHI	Rrjet pikash panoramike	Belvedere Llogara 1	Llogara	4.374.210,5 All
2			Belvedere Llogara 2	Llogara/Palase	3.338.800 All
3			Belvedere Bunec	Sarande	2,744,766 LEK
4			Belvedere Piqeras	Piqeras	14,288,507 lek
5			Belvedere Porto Palermo	Himare	4,029,557 LEK
6			Xarre	proces	

e. Aktivitete sportive dhe turistike

- Krijimi i një guide të lëvizshme me biçikleta në 4 zonat: Himarë, Qeparo, Sarandë, Ksamil
- Tracking në zona me cilësi ta lartë peisazhike: Llogara, kanioni i Gjipesë, etj.

Falë bukurive natyrore që qarku i Vlorës ka, si rrjedhojë e pozicionit gjeografik dhe relievit të larmishëm, natyrshëm lind domosdoshmëria e zhvillimit të aktiviteteve turistike që mundësojne vënien në pah të vlerave natyrore dhe kulturore. Aktualisht vija bregdetare vizitohet çdo vit e më shumë nga turistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë duke u konsideruar kështu si një nga destionacionet më të rëndësishme të Ballkanit. Mënyrat që këtyre turistëve u ofrohen për të arritur këtë zonë janë tragetet dhe makina apo linjat urbane. Format më ekologjike dhe argëtuese, për të vizituar zonat me potencial më të madh turistik përgjatë vijës bregdetare do të ishte zhvillimi i ecjeve sportive ose alpine përmes hapjes së shtigjeve të ndryshme/monopateve për këmbësorë si edhe guidave turistike më biçikleta. Gjatë gjithë vijës bregdetare do të jenë në dispozicion të turistëve 4 stacione për biçikleta: Vlorë, Dhërmi, Himarë dhe Sarandë, të cilat do të mundësojne marrjen me qera të biçikletave, tualete, riparim dhe bar. Çdo stacion do të ketë në dispozicion 30 biçikleta dhe për çdo grup guide do të jetë instruktori përkatës i cili do të mbulojë të gjitha problemet logjistike gjatë rrugëtimit.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	PEISAZHI	Aktivitete sportive dhe turistike	Guidë turistike me bicikleta	Himarë	**Total për 4 pikat: 4,045,000 All**
2			Guidë turistike me bicikleta	Qeparo	
3			Guidë turistike me bicikleta	Sarandë	
4			Guidë turistike me bicikleta	Ksamil	
5			Tracking	Llogara	
6			Tracking	Kanioni i Gjipesë	

7			Monopati gjatë vijës bregdetare Karaburun-Butrint	Ide	

2.4. Bujqesia; Blegtoria; Akuakultura

Vlora ka kushte klimatiko – tokësore shumë të përshtatshme për kultivimin e të gjitha llojeve të kulturave bujqësore (vreshta, pemishte, ullishte, agrume, kultura agrare etj.) si dhe shtimin e një sërë kategorish të kafshëve bujqësore që kanë të bëjnë me nevojat direkte të popullsisë si dhe pushuesve turistë, veçanërisht në zonat bregdetare. Produktet rurale dhe artizanati janë pjesë e rëndësishme e sektorit agroushqimor dhe përmirësimi i këtyre burimeve është i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale. Një karakteristikë tjetër në këtë fushë është pasuria rajonale e bimëve medicinale, të cilat janë të shumëllojshme. Megjithatë mbetet problem mbledhja jashtë kritereve i këtyre bimëve me vlerë natyrore dhe mjekësore.

a. Bujqesia / Blegtoria

Bujqësia luan një rol të rëndësishëm në mirëmbajtjen e peisazhit tradicional rural dhe të aktiviteteve rurale dhe, nëse nuk janë zhvilluar në një mënyrë të qëndrueshme, mund të kenë një ndikim negativ në mjedis, duke ndotur ujin dhe tokën me mbetje dhe pesticide dhe duke ulur biodiversitetin me përzgjedhje të papërshtatshme kulturore. Bujqësia ndodhet përballë ndryshimeve edhe në karakterin mjedisor, si pasojë e dëmtimit të pyjeve, gërryerjes së tokave, keqtrajtimit të sistemeve ujitës dhe kullues si dhe zënies së tokave bujqësore nga ndërtimet pa kriter. Rritja e shpejtë e numrit të gjësë së gjallë ka çuar në rritjen e stresit për ambjentin, pasi toka për kullotë synon të mbi-shfrytezohet. Problematika kryesore në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë lidhet me mungesën e infrastrukturës, mosorganizimin e prodhimit dhe tregëtimit, mungesën e standartizimit dhe bashkëpunimit midis fermerëve të vegjël.

Duke mbajtur në vëmendje që kjo është një fushë e gjerë dhe me potencial për zhvillim në qarkun e Vlorës, propozimet e kësaj pakete mbeten të hapura me mundësinë për zhvillime të mëtejshme.

Kjo paketë mund të ndahet në tre drejtime të nevojshme:

1) Studime mbi potencialin e zhvillimit të agroturizmit si edhe bimëve autoktone të zonës, vlerësim të agrumeve apo bimve të importuara për mbjellje lokale në bregdetin jugor;

2) kultivim të bimëve medicinale në mënyrë të organizuar, sherebela, bari i bletës, çaji i malit;

3) drejtimi blegtoral me kultivimin e kërmillit dhe rehabilitimin e kullotave.

Vleresimi agrobiologjik i agrumeve: Ndryshimet e viteve 1990 në Shqipëri u shoqëruan me fenomene të padëshiruara sidomos në bujqësi dhe në veçanti në fushën e pemëtarisë. Hapja me botën krijoi kushte për tregëti të lirë e për rrjedhojë edhe importin e materialit të shumëzimit bimor nga vendet fqinje Greqia dhe Italia, kryesisht fidanë agrumesh, ullinjsh apo pemësh frutore. Veçanërisht pas viteve 2000 në Butrint, Xarrë, Konispol, Vurg, etj, po shtohen me shpejtësi sipërfaqet e mbjella me agrume, kryesisht sipërfaqet e mbjella me mandarinë duke arritur rendimente mbi 60 – 80 kg/bimë. Prodhimi total në nivel kombëtar është rritur me disa herë, ndërsa prodhimi për eksport në vitin 2013 arriti në 15 000 tonë.

Në këto kushte, shtimi i sipërfaqeve të reja me kultivar të panjohur në zonat prioritare të Jugut të vendit dikton studimin e përshtatshërisë së tyre në kushtet klimateriko – tokësore të bregdetit Jonian: Sarandë, Delvinë, Himarë dhe Vlorë. Vonesat e mëtejme në trajtimin dhe ezaurimin e kësaj situate do të sillte problematika të padëshirueshme. Kjo sepse, jo çdo lloj fidani i prodhuar jashtë dhe në kushte të ndryshme nga ato të vendit tonë mund të adaptohet dhe sjellë rezultatet e pritshme në kushte të reja bujqësore.

Kultivimi i bimëve medicinal: Grumbullimi, tharja e tregtimi i Sherebelës është një "brand" tipik i produkteve të bimëve mjekësore në Shqipëri dhe për më tepër në Jug. Ajo ka siguruar prej shumë kohësh të ardhura të konsiderueshme me mundësi modeste investimi, thjesht në grumbullimin dhe tregtimin nga gjendja e saj e egër në natyrë. Mundësia e kultivimit të Barit të Bletës në zonën bregdetare jugore e perëndimore propozohet për shkak të kushteve të përshtatshme klimatike për kultivim, krahasuar me fqinjin tonë Greqinë.

Aspekt blegtoral: Në këtë pjesë përfshihet një projekt që ka si objektiv nxitjen dhe zhvillimin e kultivimit të kërmillit Helix Aspersa në ferma të vogla individuale në sipërfaqe toke të shfrytëzueshme mesatarisht 1 Ha. Prurja e përvojave të reja perëndimore, kërkesa gjithmonë e në rritje e konsumatorëve turistikë për gjellërat me bazë kërmilli, është një prurje e re në kulinarinë e Shqipërisë së Jugut, edhe pse nuk ka qenë fare i panjohur. Gjithashtu në koherencë me një prej problemeve aktuale të blegtorisë, mbi mungesën e hapësirave të nevojshme për kullota propozohet një projekt për rehabilitimin e kullotës në zonën komunës Dhiver të Sarandës.




Fig. 7 Perdorimi i tokes

Në këtë paketë është propozuar edhe një projekt "Ferma Pedagogjike" që ka një qasje sociale me ndjeshmëri ndaj mjedisit duke shfrytëzuar burimet dhe potencialet bujqësore dhe blegtorale në një zonë rurale të rajonit. Target grupi përfitues i këtij projekti do të jenë fëmijët e shkollave dhe në një optikë më të ngushtë fëmijët e shkollave të specializuara (PLM, etj) apo me probleme sociale, të cilët do të jenë vizitorët kryesorë të kësaj ferme që në praktikë do t'i afrojë më shumë fëmijët e sotëm me natyrën, si një impakt i dyfishtë mbi jetën e tyre: njohjen reale të potencialeve bujqësore dhe blegtorale të rajonit të cilit i përkasin, ashtu si edhe ndërgjegjësim për ruajtjen dhe konservimin e këtyre burimeve natyrore.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	BUJQESI/BLEGTORI	Bimet medicinale	Kultivimi i sherebelës në fshatrat e bregdetit Jon,1 Ha	Bregdetin jugor	550,000 All /1 Ha
2			Përhapja dhe kultivimi i barit të Bletës	Bregdetin jugor	3,440,589 All/Ha
3			Kultivimi i Çajit të malit	Sarandë	Ska ende
4			Rritja dhe kultivimi i kërmillit		25,000 €
5			Studimi i bimeve autoktone te bregut		
6			Vleresimi agrobiologjik i agrumeve të importuara për mbjellje lokale	Bregdetin jugor	7,014,200 lek
7			Vlerësimi i mbjelljes së Paëlonia-s në zonën e bregdetit të jugut	Bregdetin jugor	Ide
8			Rehabilitimi i kullotës së pushtuar nga drizat në Dhiver	Sarandë	250 mil All
9			Studim i potencialeve për zhvillimin e agroturizmit në qarkun Vlorë	Bregdetin jugor	Ska ende
10			Ferma pedagogjike	Bregdetin jugor	70,000 €

b. Akuakultura

Peshkimi dhe akuakultura janë aktivitete tipike në Qarkun e Vlorës dhe kanë një histori njohurish, zejesh dhe produktesh tradicionale, të ndërlidhura ngushtë me kulturën e komunitetit rajonal. Prandaj dhe përmirësimi i këtyre aktiviteteve, prandaj ndihmon në rritjen e pamjes tërheqëse të rajonit dhe në rikuperimin dhe përforcimin e ndjenjës së identitetit dhe përkatësisë së komunitetit rajonal. Për këtë arësye peshkimi dhe akuakultura shikohen si prioritare në krijimin e një perspektive të qëndrueshme mjedisore.

Laguna e Butrinti si një habitat i larmishëm dhe potencial ofron mundësi për zhvillimin e traditës së peshkimit. Për të avancuar cilësisht këtë zhvillim është evidentuar nevoja për ndërhyrje përmes plotësimit me infrastrukturë të nevojshme për peshkimin, rehabilitimit të zonave specifike në qendrën e grumbullimit dhe depurimit të midhjeve dhe më gjerë në favor të aktivitetit të peshkimit.

Sistemimi i sheshit përpara Q.G.D.: Qëllimi i këtij projekti është sistemimi i sheshit përpara Qendrës së Grumbullimit dhe Depurimit të Midhjeve. Ky projekt është i rëndësishëm, sepse në momentin që do të kemi një mol më të madh, edhe kapaciteti i transportit dhe qarkullimit te mjeteve dhe njerëzve do të zgjerohet. Sistemimi i këtij sheshi është menduar pikerisht për të përballuar numrin e madh të lëvizjeve.

Marketingu i molusqeve-pajisje me mjete mbështetese: Qëllimi i këtij projekti është pajisja me mjete mbështetëse e Qendrës së Grumbullimit dhe Depurimit të Midhjeve. Kjo qendër është financuar nga Komuniteti Evropian dhe shërben për përpunimin e midhjeve për të garantuar një produkt të çertifikuar. Këto pajisje mbështetëse janë tejet të domosdoshme për mbarëvajtjen e kësaj qendre, e cila ka për qëllim kryesor analizimin, grumbullimin dhe përpunimin e midhjeve, dhe mbi të gjitha garantimin e sigurisë ushqimore për konsumatorin.

Pajisja e inspektoriatit të peshkimit: Qëllimi i këtij projekti është të sigurojë mbarëvajtjen e monitorimit të aktivitetit të peshkimit në qarkun e Vlorës duke bërë të mundur controllin dhe evidentimin e kundravajtësve.

Rehabilitimi pjesor i kanalit të peshkut: Qëllimi i këtij projekti është të sigurojë futjen e ujit të lumit të Bistricës në sasitë e nevojshme për të përfituar kështu freskimin e ujit të lagunës si dhe për të ruajtur parametrat hidrokimikë në kufijtë e lejueshëm.

Zgjerimi i molit pranë Q.G.D: Qëllimi i këtij projekti është sigurimi i lëvizjes së një numri më të madh anijesh sepse është e domosdoshme për zgjerimin e kapaciteteve të prodhimit dhe transportit të produktit të midhjeve.

Rikonstruksioni i portave dhe nyjës së komandimit: Qëllimi i këtij projekti është rikonstruksioni i portave hyrëse të ujit të ëmbël si dhe të nyjes së komandimit. Ky projekt bën të mundur ruajtjen e parametrave hidrokimikë (O2, pH, Sal) në kufijtë e domosdoshëm për kultivimin dhe rritjen e midhjeve për të mos shkaktuar frenime në rritjen e tyre ose çuarjen në ngordhje masive.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	AKUAKULTURA	Peshkimi	Sistemimi i sheshit para Qendrës së Grumbullimit dhe Depurimit të midhjes	Sarande	3,003,130 LEK
2			Kompletimi i laboratorit të autokontrollit pranë QGD Manastir	Sarande	34, 000$
3			Pajisja e Inspektoriatit të peshkimit me mjete lundrimi	Sarande	40, 000 $
4			Marketingu i molusqeve bivalore dhe ndërhyrjet për rritjen e kapaciteteve dhe konkurrencës në sektorin e	Sarande	?

			marketingut të molusqeve		
5			Pastrimi i lagunës së Butrintit	Sarande	35,000€
6			Shkallë riparim anijesh (prioritet i politikave detare)	Sarande	20,000,000 All
7			Market peshku në Sarandë	Sarande	300,000 $
8			Rehabilitim i zonës së Pallavraqit në luginën e Butrintit (Ndarja e moluskut nga guacka)	Sarande	2,960,544 All
9			Rehabilitimi pjesor i kanalit të peshkut	Sarande	3,309,782 All
10			Zgjerimi i molit pranë QGD Manastir	Sarande	3,250,746 All
11			Rikonstruksioni i portave dhe nyjes së komandimit	Sarande	3,259,216 All

c. Gjeologjia

Duke konsideruar strukturen gjeologjike qe eshte ndertuar kryesisht prej depozitimeve gelqerore dhe me pak prej depozitimeve te tjera, rajoni bregdetar jugor ka dy tipe te makrozonave lidhur me rreziqet gjeologjike. i pari perfaqesohet nga formacionet e forta (shkembinjte gelqerore), dhe tjetri nga formacionet e lehta (argjilat, shkembinjte ranore dhe konglomeratet). Zonat respektive pershkruhen me poshte.

Formacionet e forta (Guret gelqeror). Keto formacione kane te bejne me gure gelqerore mjaft te forte. Zakonisht, ato mbulohen nga depozitat koluviane ne zonat me pjerresi te vogel e gjithashtu ne zonat me rryme. Shkembinjte e formuar nga keto formacione jane shume te qendrueshme. Keto struktura ndonjehere zhyten nen nivelin e detit. Duhet nenvizuar qe nga pikpamja gjeoteknike, problemet e vogla duhen paraprire dhe strategjite e parandalimit duhen zhvilluar gjate fazes se ardhshme te projektit.
Formacionet e lehta (argjilat, shkembinjte ranore dhe konglomeratet). Zakonisht, pjerresite jane te qendrueshme, por ndonjehere rreniet e tokes dhe blloqe me permasa te vogla jane vene re ne raste ne pjerresite me formacione te tilla. Keta gure gjenden kryesisht (shih Harten 2) ne zonen midis Borshit dhe Perparimit (Shen Vasil) Ne keto struktura ne pergjithesi jane lokalizuar problemet e instabilitetit te terrenit. Problematikat kryesore duhen lidhur me evenimentet sizmike. Zona e studimit eshte nje zone sizmike relativisht aktive, me nje aktivitet te njohur qe arrin deri ne 5.8 te shkalles Rihter apo intensitet 9 sipas shkalles Mercali. Ne rajon ka patur disa termete te fuqishme me te cilet mund te lidhet edhe morfologia e pasur e zones me shpella, humnera dhe forma te tjera karstike permes shkembinjve gelqerore.
Kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike te vendeve ne zonen e studimit, me potencial per zhvillime fizike (turizem dhe te tjera), jane pergjithesisht te mira. Ne disa vende ekzistojne rreziqe te vogla te fenomeneve negative fizike e gjeologjike ne zona te lokalizuara.




Fig. 7 Zonat me rreziqe gjeologjike

Ne zone jane vene re disa problematika imediate si shkarje te tokes apo shkëputje nga shpatet te materialeve te ngurta, te cilat kerkojne ndërhyrje urgjente per te risjelle ne siguri disa pjese te territorit.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1		Rreziqe gjeologjike	Studim për rrëshqitjen e tokës në Llogara	Llogara	2,680,000 LEK

d. Mbetjet Urbane

Pavaresisht nga perpjektjet e fundit te materializuara ne ndertimin e nje zone grumbullimi ne Sarande, gjendja akoma mbetet nje shqetesim i madh, ku ka shume vende shkarkimi te jashteligjshme, mungese te strukturave mbledhese dhe shkarkuese ne shume zona, te cilat shkaktojne degradimin e natyres, rritjen e grumbujve te mbeturinave te ndertimit buze rrugeve kryesore. Kohet e fundit ka perfunduar, me financim nga Banka Boterore, “nje studim para-pergatitor dhe nje studim per manaxhimin e ndotjeve te ngurta”, i cili ka prezantuar me sukses konceptin e perqasjes se objektivave te projektit dhe implementimin e ketyre objektivave. Per shkarkimin e ndotjeve te ngurta ne te ardhmen jane vleresuar dhe analizuar tashme dy vende ne Vuno dhe Bajkaj (deri ne fazen e zbatimit). Lidhur me kete, zona e studimit mund te analizohet per 4 pikat kryesore te cilat perfshijne njesite administrative dhe prodhuesit e rendesishem te

mbetjeve te ngurta dhe mbetjeve te ndertimeve: Himara dhe rajoni i saj, Lukova, Saranda dhe Ksamili.
Nga legjislacioni ne fuqi studimi dhe menaxhimi i mbetjeve mbetet ne konpetecat e bashkive dhe komunave perkatese. Ka disa plane ne studim dhe te realizuara si Landfilldi i Sarandes; i Himares dhe i Vlores te cilet jane ose ne faze realizimi ose ne pritje te fondeve.

2.5. Hidrologjia dhe resurset ujore (15)

Kushtet hidrogjeologjike dhe hidrologjike
Me poshte jane dhene karakteristikat kryesore te hidrogjeologjise dhe hidrogjeografise te zones se studimit: rrjeti hidrografik i zones, pershkrimi i burimeve ujore nentokesore dhe vleresimi i kapaciteteve te tyre dhe mundesive qe ato ofrojne per zhvillimin ne te ardhmen, vecanerisht per turizmin. Vleresimet bazohen ne studimet ekzistuese, sikurse dhe ne disa vezhgime te fundit ne terren.
Rrjeti hidrografik
Zona bregdetare pershkohet nga nje sere lumenjsh, perrenjsh dhe rrymash nga te cilat me te rendesishme jane: perroi i Dukatit, Kudhesit dhe Borshit ne pjesen veriore te zones se studimit, dhe lumenjte e Bistrices, Kalases dhe Pavllos ne pjesen jugore. Laguna e Butrintit eshte njesia me e rendesishme e vecante hidrografike. Si shtese, ka eshe disa perrenj e rreke te vogla qe pershkojne zonen. Pjesa veriore e zones se studimit konsiderohet si rrjeti hidrologjik siperfaqesor me i varfer ne Shqiperi. Ky rrjet, me rrjedhjet kryesore ka keto karakteristika:


- **Perroi i Dukatit** buron nga malet e Dukatit dhe derdhet ne det ne gjirin e Vlores/Orikum. Ka uje gjate dimrit me shira, ndersa ne vere eshte pothuajse i thare.
- **Perroi i Kudhesit** buron nga malet ne lindje te vijes bregdetare dhe derdhet ne det. Ne piken ku ai bashkohet me detin, krijon depozitime aluviale ne forme delte. Ky perrua ka uje gjate dimrit dhe transporton materiale te ndryshme te ngurta me vete.
- **Perroi i Borshit** buron nga lindja e fshatit te Borshit dhe derdhet ne detin Jon. Gjate periudhave te reshjeve, ky perrua transporton materiale te ndryshme me vete dhe prurjet e tij krijuan fushen e Borshit dhe plazhin e Borshit. Ky perrua ka shume uje ne dimmer, ndersa ne vere, uji eshte shume i paket

Pjesa jugore e zones se studimit ka nje rrjet hidrologjik krejt te kundert, qe eshte nder me te pasurit me burime ujore ne gjithe Shqiperine:

- **Lumi i Bistrices** buron nga Syri i Kalter. Ky eshte nje burim natyror me sasi konstante uji. Perroi i Vrisit bashkohet me kete lume dhe te dy derdhen ne kanalin e Cukes(bashke me lumin e Kalases). Sasia e ujit te lumit eshte konstante dimer - vere, dhe eshte lumi me prurjen me te madhe ne rajonin bregdetar jugor (19 m3/s).
- **Lumi i Kalases** buron nga rreza e Malit te Gjere (burime karstike) qe perbehet nga gur qelqeror. Ai ka nje sasi konstante uji ne vere dhe dimer, dhe bashkohet me lumin e Bistrices para se te derdhet ne kanalin e Cukes dhe me pas ne detin Jon.

Rezervat ujore nentokesore

Kushtet hidrogjeologjike varen nga struktura gjeologjike dhe morfologjike e zones bregdetare. Mund te verehen rezervat e meposhteme hidrologjike te ujerave nentokesore: Rezervat hidrogjeologjike nga burimet natyrore. Ne zonen e studimit ka nje sere burimesh ujore natyrore



me nje sasi te konsiderueshme prurjeje. Gjithashtu, ujerat kane nje cilesi te mire. Keto burime kane origjine karstike dhe krijohen ne nivele te ndryshme hipsometrike. Burimet kryesore jane: burimi i Ujit te Ftohte ne Vlore, nen nivelin e detit, Izvori ne Tragjas, burim ne fshatin Dhermi, Potami Spille, Mulliri i Janit ne Qeparo, Hoston Qeparo, Borsh, Ftere, Sasaj Piqeras, Syri i Kalter, Kardhikaqi, Vrisi, Tatzatit, Mezalake, Shkalla, Ajtoi dhe, Çuka.

Rezervat hidrogjeologjike te gureve gelqerore. Sic u permend me pare, ne bregdetin jonian ka shume shkembinj gelqerore. Ne keto shkembinj ka evoluar fenomeni i karstit. Ka shume rezerva te ujerave nentokesore, sic jane burimt e permendura me lart. Ujerat e gjetura ne keto shkembinj kane indikatore shume te mire te cilesise.

Rezervat hidrogjeologjike te formacioneve te flishit. Keto formacione perbehen nga gure argjilore dhe ranore. Ato kane nje pershkueshmeri te ulet dhe rezervat e ujit nentokesor jane te pakta. Ne keto shkembinj jane gjetur burime te perkohshme uji.

Rezervat hidrogjeologjike te depozitimeve te Kuaternarit. Depozitimet e Kuaternarit perbehen nga argjili, rera dhe zhavorri. Shtresat e reres dhe zhavorrit jane akuafere. Keto depozitime

gjenden ne zoan te sheshta si ne Dukat, Borsh, dhe Vurg (Delvine). Ne keto lugina ka puse hidrogjeologjike dhe sasi te mjaftueshme uji. Ne disa raste ka puse arteziane, por ne rastet e tjera uji duhet pompuar.

Shqetesimet per perdorimin e burimeve ujore

Zona nga Orikumi ne Butrint eshte e pasur me burime ujore, vecanerisht ne pjesen jugore te zones se studimit. Ne kete faze te hershme te projektit, mund te konkludohet se burimet ujore ne zone e studimit jane te mjaftueshme qe te plotesojne kerkesat qe vijne nga rritja e konsumit ne te ardhmen, sic eshte kerkesa qe krojohet nga zhvillimi i turizmit. Uji i burimeve ka karakteristika te mira.

Ka nje sere burimesh natyrore qe gjenden jashte zones se studimit. Per momentin ata jane te mbrojtur, pasi vendodhjet e tyre jane larg zonave te zhvilluara urbane. Megjithate, ne pjanifikimet e ardhshme per zhvillime, duhen marre ne konsiderate edhe masa mbrojtese shtese. Kjo i referohet vecanerisht disa burimeve qe mund te jene te ekspozuara shume shpejt ndaj ndikimeve negative urbane, sic jane burimet e Ujit te Ftohte ne Vlore, Izvori ne Tragjas, dhe Potami ne Spille (Himare). Per te percaktuar zonen e sigurt higjenike perreth secilit prej burimeve te mesiperme, duhet bere nje studim i vecante hidrogjeologjik.

a. Zhvillimi i Bregdetit

Zona bregdetare e qarkut Vlorës është zonë e mbrojtur, ku konservimi i natyrës dhe i biodiversitetit duhet të sigurojë një platformë për tipet e turizmit dhe të ndërhyrjeve në infrastrukturë, që janë të përshtatshme për mbrojtjen e mjediseve të marinës, tokave të lagura dhe tokësore.

Për zhvillimin e zonës bregdetare është parashikuar promovimi i botës ujore dhe nënujore përmes studimit për krijimin e një akuariumi, ku do të prezantohet me ndihmën e një teknologjie perëndimore gjithë gama e faunës dhe florës së bregdetit jugor si edhe krijimit të një qendre zhytjeje brenda kritereve profesionale të këtij sporti nënujor. Është menduar që kjo qendër zhytjeje të ndërtohet në zonën e Radhimës për disa arësye: është një zonë të frekuentuar më së shpeshti nga publiku i gjerë përfshirë edhe atë turistik për shkak të lehtësimit të transportit; është në një distancë e afërt me zonën e Sazan Karaburunit të cilat do të jenë zonat fokale për eksplorim nënujor, duke patur në vëmendje që zona e gjirit të Vlorës dhe gadishullit të Karaburunit, deri në Dhërmi, është investiguar për identifikimin e vendeve potenciale për zhytje. Topografia interesante nënujore me shpella e mikrohabitate shumë të larmishëm, si dhe prania e anijeve të mbytura i japin zonës më tepër vlera turistike, veçanërisht për të apasionuarit pas sportit të zhytjes.

Gjithashtu nga studimi i terrenit ashtu si edhe konsultimet me përfaqësues të njësive vendore është paraqitur nevoja e aksesit në plazhet e virgjër, të pafrekuentuar për shkak të zonës që, në disa raste është i thepisur, ndërsa në raste të tjerë ka nevojë për çeljen e shtigjeve natyrorë për të lehtësuar frekuentimin e tyre nga komuniteti i turistëve, duke qenë për ta një tërheqje ekskluzive si plazhe të virgjër. Kjo ndërhyrje është parashikuar të bëhet në harmoni me natyrën ku, në rastet e brigjeve të thepisur propozohen shkallët prej druri për kalim, ndërsa për rastet e tjerë çelja e shtigjeve dhe lehtësimi i aksesit për këmbësorët plazhistë.Në këtë kuadër propozohen edhe pesë projekte për përmirësim dhe lehtësim aksesi në plazhet e bukur në bregdetin e Sarandës përmes ndërtimit të segmentëve rrugorë që do të ndikojnë në zhvillimin e turizmit bregdetar të Ksamilit[6], duke krijuar kushte bashkëkohore për turistët dhe vizitorët e shumtë në plazhet e virgjëra të kësaj zone. Kjo ndërhyrje do të krijojë impakt ekonomik tek banorët e zonës përmes lëvizjes komode dhe në kohë të shkurtër të turistëve dhe banorëve të zonës.

Në këtë kuadër propozohet edhe plotësimi i infrastrukturës së këtyre plazheve dhe plazheve të tjerë të frekuentuar më parë me tualete plazhi, caktimin e pikave të notimit, bovave, ashtu si edhe krijimi i hapësirave për parkimin e makinave, aty ku është e mundshme dhe e përshtatshme për mjedisin përreth.

[6] Projektet e propozuar janë prioritet i Komunës Ksamil dhe janë përfshirë në Planin e Zhvillimit Lokal duke u bërë pjesë edhe e prioriteteve të Qarkut Vlorë.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	ZHVILLIMI I BREGDETIT	Akses në plazhet e virgjër të jugut	Akses në plazhin e Pasqyrave	Sarandë	30,815,172 All
2			Akses në plazhin e Pulëbardhave	Sarandë	35,668,778 All
3			Akses në plazhin Pema e Thatë	Sarandë	39,134,410 All
4			Akses në gjirin e Hartës	Sarandë	29,161,272 All
5			Akses në plazhin e Manastirit	Sarandë	17,104,438 All
6			Akses në plazhin, komuna Aliko	Aliko	Ska ende
7		Përmirësim i infrastrukturës për zhvillimin e bregdetit	Parkim automjetesh për akses në zonën e bregdetit	Te ndryshme	Ne proces
8			Tualete plazhi	Te ndryshme	Ne proces
9			Përcaktimi i pikave kufizuese në det (bovat) me qëllim ruajtjen e publikut	Bregdetin Jugor	ide
10		Promovim i pasurive ujore dhe nënujore bregdetare	Qendër zhytjeje	Bregdetin jugor	Ne proces
11			Studim për realizimin e një akuariumi në bregdetin e Vlorës	Bregdetin jugor	520,000 €

b. Lumenjtë e Përrenjtë

Shumë lumenj të qarkut kanë një regjim stinor. Edhe pse rrjedhat e tyre janë kontrolluar përmes ndërtimit të pritave për të parandaluar përmbytjet e mundshme, fenomeni i shfrytëzimit pa kriter i zhavorreve të lumenjve gjatë viteve të fundit ka bërë që disa pika të kalimit të lumenjve të përcaktohen problematikë në periudhën e shirave të dimrit. Në disa raste janë prishur argjinaturat e lumenjve duke krijuar në disa zona edhe situata përmbytjeje. Projektet e devijimit të ujërave dhe ato të ndërtimit të digave janë aktualisht kërcënimi më i madh për lumenjtë duke vënë në rrezik pasuritë biologjike, funksionet ekologjike dhe hidrologjike të këtij ekosistemi unik ashtu si edhe humbjen e vlerave turistike.

Një kërcënim tjetër shqetësues është edhe mungesa e sistemeve të menaxhimit të mbetjeve. Intervale të mëdha të brigjeve të lumenjve janë të ndotura nga plehrat e pakontrolluara. Jane lokalizuar zona me ndotje te medha ne shtretet e perrenjeve si Perroi i Iliasit, Perrenjte e Himares, gryka e përroit ne Dhermiun e Vjeter, etja
Gjithashtu e njëjta problematike eshte hasur ne bregdet: Zona e pemes se thate ne Ksamil, Perroi i shen Vasilit, Perroi i Palases (plazhi i rrugeve te bardha) etj ..

Nje fenomen tjeter eshte ai i prishjes së argjinaturave të lumit për shkak të shfrytëzimit jashtë kritereve për material ndërtimi është identifikuar në lumin Bistricë dhe Pavlla e Madhe, ku është

parashikuar ndërtimi i argjinaturave dhe paneleve mbrojtës me qëllim mbrojtjen e brigjeve të këtyre lumenjve.
Gjithashtu një problematikë e tillë është hasur edhe me përrenjtë Ilias, Borsh, tre perenje e Himares ku ne periudha me rreshje te dendura kemi vërshime te menjehereshme apo dalje nga shtrati

Rehabilitimi dhe integrimi i sistemeve të kanalizimit për të ujitur fushat, gjithashtu nëpërmjet rikuperimit të kanaleve të kullimit të braktisura, shpesh të mbushura me mbeturina është një aspekt tjetër i ndërhyrjes mjedisore

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	HIDROLOGJIA	Lumenjtë, përrenjtë	Mbrojtje nga Bistrica e Madhe Krahu i Majtë 500m poshtë urës së Kranesë		25,872,698 LEK
2			Mbrojtje nga Bistrica e Madhe zona e parë Krane-Delvinë		22,780,431 ALL
3			Mbrojtje nga Bistrica e Madhe zona e dytë Krane-Delvinë		26,868,142 LEK
4			Mbrojtje nga Pavlla e Madhe Krahu i Djathtë zona e parë Mursi	Sarandë	14,549,660 LEK
5			Mbrojtje nga Pavlla e Madhe Krahu i Djathtë zona e dyte Xarë	Sarandë	16,550,873 LEK
6			Mbrojtje nga Pavlla e Madhe Markat	Sarandë	25,782,138 LEK
7			Riparim i dëmtimeve mjedisore në përroin Iliaz	Himarë	1,192,980 lek
8			Riparim i dëmtimeve mjedisore në përroin 1 Himarë	Himarë	Ne proces
9			Riparim i dëmtimeve mjedisore në përroin 2 Himarë	Himarë	Ne proces
10			Riparim i dëmtimeve mjedisore në përroin 3 Himarë	Himarë	Ne proces
11			Rehabilitimi i kanalit kryesor vaditës Piqeras-Sasaj-Nivicë	Lukovë	Ne proces


c. Pershkrim i burimeve ujore ne rajon

Ne pergjithesi konsiderohet se zona nuk ka mungesa te burimeve te ujit, kryesisht te ardhura nga lumjente malore; megjithate, kapacitetet e ujrave nentokesore jane perdorur (per shembull ne Himare) por me sasi te kufizuara (ne qytetin e Himares, uji i cezmes eshte i kripur). Vendodhja e burimeve kryesore ujore eshte

dhene ne Harten 10. Disa pika, siper shembull plazhi i Palermos, kane kufizime ne burimet e tyre ujore: asnje uje siperfaqesor dhe asnje burim nentokesor i njohur. Keto duhet te merren parasysh me kujdes ne cdo analize skenaresh Pervec ketij perjashtimi, perdorimi i burimeve te tjera ujore nuk do ishte shume shqetesues: lumenjte e Qeparoti dhe Vunoit paraqesin rrjedhje te rendesishme, gjithashtu ekzistojne disa burime te pashfrytezuara si p.sh Burimi i Buronjes ne thellesi te Qeparoit dhe ai i Syrit te Kalter ne afersi te Sarandes, te cilet perfaqesojne kapacitetet te perhershme dhe te rendesishme. Burime te tjera nenujore te bollshme gjenden ne zonen e drejtimit me te ulet te Kanalit te Cukes. Aktualisht, ato jane pjeserisht te shfrytezuara per furnizmim me uje ne Ksamil. Duke vijuar, ne thellesi te Sarandes gjenden ujra nentokesore dhe burime ujore te nje kapaciteti mjaft te madh.

Ne vitet e fundit jane zhvilluar disa investime te financuara nga Banka Boterore apo Fondi Shqiptar i Zhvillimit si ujesjellesi i Sarandes, Himares etj. Keto ivestime dalin nga ky program pasi po ndiqen nga nje program paralel i Ministrise se Zhvillimit Urban dhe te Turizmit.

2.6. Energjitë e rinovueshme (5)



Qarku i Vlorës, për vet pozicionin e tije gjeografik ka një potencialitet te larte për zhvillimin metodologjive te prodhimit te energjisë se rinovueshme ne mënyre te veçante te asaj elektrike. Zhvillimi urban i copëzuar sidhe destinacioni kryesor i këtyre zonave, ai i turizmit, i bën terrene ideale për zhvillimin e merkatos se mikroimpianteve te gjenerimit te energjisë elektrike. Me mesatarisht 2500 ore diell vjetore dhe shpejtësi ere 3.2 m/s, te mjaftueshme për mikroimpiante te prodhimit te energjisë elektrike apo asaj termike. Këto impiante me kosto te ulet do te jene te përdorshme nga banesat apo hotelet për integrimin e nevojave te tyre sidomos me periudhat me ngarkese maksimale.

Për këtë paketë janë propozuar 5 projekte të cilat fokusohen në shfrytëzimin e energjisë eolike dhe solare për qëllime të ndryshme sipas specifikave të ndërhyrjeve të tilla si: gjenerim i rrymës elektrike për ndriçim përmes 3 mikrondërhyrjeve me impiante eolike me fuqi 1 kë, 3kë dhe 10 kë si edhe me impiante fotovoltaike 20-25 kë (e propozuar specifikisht për institucionet shtetërore); nxjerrjen e ujit nga puset përmes një pompe eolike si një suport i mirë i popullsisë rurale në të mirë të ortikulturës dhe rritjes së kafshëve; ngrohje e ambjenteve të brendshme përmes një sistemi termosolar.
Këto sisteme ose impiante i përkasin gjeneratës së re të energjive të rinovueshme. Thjeshtësia e funksionimit dhe instalimit të tyre lejon realizimin e integruar në sistemet ndërtimore dhe urbane. Në parimin e përgjithshëm këto impiante ndahen në dy makrotipe: stand-alone dhe grid-connected, i pari i veçuar nga sistemi i shpërndarjes elektrike, ndërsa i dyti që shkëmben vazhdimisht rrymë me sistemin.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	ENERGJITË E RINOVUESHME		Studim i potencialit për shfrytëzimin e energjisë eolike në qarkun e Vlorës	Qarku i Vlores	40,000€
2			Studim për realizimin dhe montimin e një impianti fotovoltaik 25 KË pranë godinës së qarkut Vlorë (e adaptueshme edhe për godina të tjera institucionale)	Qarku i Vlores	51,500 €
3			Energjia mikroeolike në Llogara	Qarku i Vlores	35,000 €
4			Pompa eolike për nxjerrjen e ujit nga puset	Qarku i Vlores	10,500 €
5			Aplikimi i një sistemi termosolar në zonën e bregdetit të jugut	Qarku i Vlores	8,000 €

3. SISTEMI I MENAXHIMIT

Është i nevojshëm një monitorim i vazhdueshëm i veprimeve të proceseve të natyrshme dhe të stresit antropogjen të territorit, me qëllim që të vlerësohen në mënyrë sasiore dhe cilësore burimet në dispozicion si edhe evolucionit të tyre me kalimin e kohës, ku parashikohet edhe parandalimi i rreziqeve mjedisore.

3.1. Sistemi i kërkimit dhe monitorimit me synim ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e territorit

Si hap i pare drejt vendosjes se nje sistemi te integruar te menaxhimit bregdetar ne Shqiperi , duhen konsideruar dy komplete masash: ligjore dhe institucionale.

Ne vitet e fundit eshte krijuar nje baze e mire ligjore per ruajtjen dhe zhvillimin e territorit sidomos per zonat e mbrojtura me: Nr.10 234, datë 18.2.2010 "*PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË ZONËS BREGDETARE NË MESDHE*"; Ligji Nr. 8905, date 6.6.2002" LIGJ Nr. 111/2012 "*PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE*" nr. 10 431, datë 9.6.2011"*Për mbrojtjen e mjedisit*" etj. Nderkohe qe nevojiten marrëveshje me te sakta bashkëpunimi dhe nje perditesim i kompetencave sidhe i mjeteve te kontrollit ne institucionet lokale.

Si pike fillimi per nje menaxhim efikas qendrojne nevojat per mbikëqyrje e kontrollin kundrejt demtimeve natyrore apo njerezore

Drejtimet kryesore

Mbrojtja e territorit nga ndertimet pa leje:

Masa te menjehershme per te permiresuar efektivitetin e policise ndertimore ne parandalimin e ndertimeve te reja.

Cdo ndertim rezidencial apo turistik brenda zones bregdetare duhet te behet vetem pas adoptimit te nje plani te detajuar rregullues (studime urbanistike pjesore) te miratuar nga Keshilli Rajonal i Rregullimit te Territorit.

Ne perdorimin e tokes per turizem jashte zonave urbane nuk duhet lejuar asnje ndertim apo strukture akomodimi te turisteve ne nje brez 100 m nga bregu i detit. Brenda këtij brezi lejohen nderhyrje qe perfshijne: hapesira publike si qendra argetimi, kende lojerash, shetitore pergjate bregut, lehtesira per ushqim apo argetim per turistet, si dhe infrastrukture bregdetare (porte, porte jahtesh).

Permiresimi i mbikqyrjes dhe kontrollit te zones, per te ndaluar degradimin e metejshem te saj.

Ndarja e territorit sipas karakteristikave dhe biodiversitetit dhe ngritja e rregulloreve te veçanta per aktivitetet ne cdo zone dhe integrimi i tyre ne planet pjesore urbanistiche.

Rritja e efektivitetit te inspektoratit mjedisor ne mobilitet, resursa dhe kompetenca

Ndalimi i shfrytëzimit te tokes per ekstraksione ne zonen bregdetare dhe shtratet e perrenjeve.

Punimet teknike dhe ne Infrastrukture per permiresimin e mbikqyrjes

Hapja apo sistemimi i shtigjeve qe japin akses ne zona te mbyllura si parqe, plazhe vija ujore apo zona qe mund te jene objekt ndotje, dëmtimi nga njeriu apo depozitim mbetjesh

Krijimi i ndërtesave te vogla provizore te perdoreshme ne menyre te perkoheshme apo te perhereshme nga roje apo inspektore

Krijimi i nje rrjeti kamerash ne pika panoramike per nje kontroll te vazhdueshem te territorit

Kontrata dhe akses per shërbime satelitore si lajmërimi kunder zjarreve, ndotja, apo zhvillimi i bimesise.

Fotografi ajrore periodike nepermjet droneve apo aparatura te ngjashme, te zonave te gjera, per ndertimin e nje database historiku ndryshimi apo evolucioni per tu përdorur per studime apo identifikuar mekanizma demtimesh.

Organizimi i aktoreve lokale

Nritja e kapaciteteve dhe forcimi i shoqatave lokale te mbrojtjes mjedisore

Organizimi, pjesemarrja dhe sensibilizimi ne organizatat sektoriale si hotelerite, peshkimi, pronaret e vegjel, per nevojat dhe benefitet mjedisore

Organizimi i nje sistemi per mikrokoncesione ne fushen e blegtorise apo te aktiviteteve ne respekt te mjedisit ne zona me veshtiresi aksesi, per mbikëqyrje dhe mirëmbajtje te zonave.

Studime, kerkime dhe monitorime

Hartezimi i specieve dhe i shtrirjes gjeografike te tyre, jo vetem ne zonat e mbrojtura por ne te gjithe territorin objekt studimi, me kujdes te veçante per speciet ne rrezik

Marreveshje me qendra studimore si Universitete apo Institute per studime te vecanta per klasa te vecanta apo ne rrezik ne biodiversitet.

Monitorimi i cilesise se ujit me kudes te veçante per burimet e ujit te pishem.

Monitorimi i cilesise se ajerit sidomos ne zonat prane sipërfaqeve te banuara

Monitorimi i cilesise se truallit bujqësor ne ngarkesen ne pesticide sidomos ne zonat ujembledhese

Monitorim i vazhdueshem i aktiviteteve me koncesione per shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3.2. Çertifikimi i operatorëve turistikë

Në jugun e Shqipërisë, si një destinacion turistik i rëndësishëm, shihet shumë e domosdoshme nevoja për implementimin dhe zbatimin e skemave të çertifikimit të lidhura me turizmin, si një zgjidhje komode e cila do të sigurojë vendosjen e standarteve dhe unifikimin e tyre në një shkallë të gjerë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Skemat e çertifikimit në lidhje me turizmin do të mundësojne rritjen e visibilitetit për produktet turistike nga klientet, promovim më të gjerë të aktiviteteve turistike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe shërbime të një cilësie të lartë nga operatorët turistike në vend, gjithmonë në harmoni me mjedisin dhe trashëgiminë kulturore. Përfitimet prej implmentimit të skemave të çertifikimit në turizëm janë shumë të ndjeshme në shoqëri, mjedis dhe organet qeverisëse në vend. Këto të fundit do të nxiten të krijojnë apo përshtasin një plan monitorimi dhe menaxhimi në përqasje me skemat e çertifikimit.
Krahas çertifikimit të operatorëve turistikë ku përfshihen hotelet, restorantet dhe shtëpitë e pritjes për turistë (hostel) etj, një numër jo i vogël skemash çertifikimi mundësojnë këtë shërbim edhe për aktivitetet turistike si ekspedita në natyrë, guida, sport, kulturë etj., apo për destinacione dhe kompanitë e transportit.

NR	TEMATIKA	PROGRAMI/PROJEKTE TE INTEGRUARA	TITULLI I PROJEKTIT	ZONA	VLERA
1	SISTEMI I MENAXHIMIT	Monitorimi	Projekt per monitorimin e pyjeve; ujërave, tokës; derdhjes së ujërave të zeza nga anijet...	Bregdetin jugor	Në proces
2		Kontrolli i cilësisë	Çertifikimi i operatorëve dhe aktiviteteve turistike drejt zhvillimit të turizmit të qëndrueshem	Bregdetin jugor	18,076,000 LEK